REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 20.07.2020; 23.07.2020; 30.07.2020 dhe 07.08.2020.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 20.07.2020; 23.07.2020; 30.07.2020 dhe 07.08.2020.

***Naureda Llagami***: Përshëndetje të gjithëve!

Siç jeni vënë në dijeni, sot po zhvillojmë mbledhjen e datës 17 shtator 2020.

Siç jeni vënë në dijeni në rendin e ditës janë 17 çështje, por jo më larg se dje, nga ana e stafit administrativ, ju është përcjellë për t'u futur në rendin e ditës edhe një çështje e cila ka të bëjë me caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, kjo për shkak se me botimin në Fletoren Zyrtare tashmë fillon zbatimi i saj.

Jemi dakord që ta përfshijmë si çështje 18, pas shqyrtimit të 17 çështjeve?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, përfshihet çështja në rendin e ditës me nr. 18.

Atëherë, pa humbur kohë le të kalojmë tek rendi i ditës.

Çështja e parë është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave: 20.07.2020; 23.07.2020; 30.07.2020 dhe 07.08.2020.

Nga ana e stafit administrativ ju janë përcjellë procesverbalet.

Jemi dakord me përmbajtjen e tyre?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord, me përjashtim të procesverbalit të datës 30 korrik.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord, përveç datës 23 korrik.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datave 20.07.2020; 23.07.2020; 30.07.2020 dhe 07.08.2020.

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi dhe publikimin e këtyre procesverbaleve Kryetarja e Këshillit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

*      *      *

(Pika e 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***<u>Pika 2 e rendit të ditës me objekt</u>:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele", përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele", përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Ilir Toska).

***Naureda Llagami***: Kalojmë pa humbur kohë në çështjen tjetër të rendit të ditës.

Siç jeni në dijeni, sot nga ana e Këshillit do kalojë një nga rregulloret, edhe kjo shumë e rëndësishme, e cila ka të bëjë "Mbi kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele", përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Ky është një nga aktet e tjera të rëndësishme që Këshilli do të marri në shqyrtim, një akt i cili është hartuar së bashku me asistencën e ndërkobëtarëve, partnerëve tanë që na asistojnë pranë Këshillit. Gjithashtu është një akt i cili i është nënshtruar edhe konsultimit në të gjithë trupën gjyqësore.

Për më shumë detaje, unë do doja t'ia jepja fjalën zotit Ilir Toska, Kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit.

***Ilir Toska***: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin "Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve", projektvendim për të cilin ju kemi shpërndarë edhe relacionin shpjegues.

Ky projektvendim është përgatitur nisur nga fakti se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përmbushje të përgjegjësive për mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, në respektim të parimit qeverisës të efiçencës, në ushtrim të kompetencave në lidhje me administrimin e sistemit gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

dhe nenet 42 dhe 43 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke qenë përgjegjës për transferimin e gjyqtarëve, ndërsa ka filluar procesin për miratimin e rregullave më të detajuara, ka përgatitur edhe projektvendimin për të cilat do duhet të përcaktojmë rregulla për kriteret dhe procedurën që zbaton Këshilli i Lartë Gjyqësor për renditjen e gjyqtarëve që kandidojnë për lëvizjen paralele, që është një nga mekanizmat e institutit juridik të transferimit të gjyqtarëve.

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka hartuar projektvendimin sipas autorizimit të ligjit, pikërisht nenet 43, pika 12 të Ligjit për Statusin, i cili përcakton shprehimisht se Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë:

a) kriteret për vlerësimin etik dhe profesional ndërmjet magjistratëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta; d) zbatimin dhe përshtatjen e këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

Projektvendimi objekt shqyrtimi, rregullon vetëm kriteret dhe procedurën për renditjen e kandidatëve për lëvizjen paralele, pasi procedura e vlerësimit dhe pikëzimit për gjyqtarët është rregulluar me akte të tjera.

Duhet nënvizuar faktin se hartimi i këtij projektvendimi ka ardhur si rezultat i komunikimeve të vazhdueshme nga takimet e mbajtura me misionet partnere kryesisht EURALIUS dhe USAID, të cilët kanë dhënë një kontribut të çmuar në këtë drejtim.

Po ashtu, duhet përmendur se projektvendimi iu është dërguar paraprakisht të gjitha gjykatave me qëllim për të marrë çdo koment dhe sugjerim nga ana e gjyqtarëve, ndërsa pati të tilla vetëm nga dy gjyqtarë, të cilat iu janë shpërndarë paraprakisht edhe anëtarëve.

Lidhur me përmbajtjen e këtij projektvendimi, ai përbëhet nga 8 Krerë, të cilët në mënyrë të përmbledhur përmbajnë rregullime si vijon:

Në Kreun I të projektvendimit, titulluar "Qëllimi, fusha e zbatimit dhe subjektet", përcaktohet qëllimi i projektvendimit, që është përcaktimi i rregullave të detajuara për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve sipas Ligjit për Statusin. Ky projektvendim është i zbatueshëm për gjyqtarët që kandidojnë dhe që përmbushin kriteret ligjore për lëvizjen paralele në pozicionet e mëposhtme: a) gjyqtar në një gjykatë të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm; b) gjyqtar në një gjykatë administrative të shkallës së parë; c) gjyqtar në një

gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm; ç) gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit. Këto rregulla zbatohen për pozicionet e lira të përhershme dhe për ato që pritet të bëhen të tilla brenda 3 muajve, si dhe, për aq sa është e mundur, edhe për pozicionet e lira të përkohshme. Subjekte të këtij projektvendimi janë gjyqtarët që kandidojnë për lëvizje paralele sipas përcaktimeve të nenit 43, pika 2, të Ligjit për Statusin dhe konkretisht: a) gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ; b) gjyqtarët e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe administrativ; c) gjyqtarët e komanduar; ç) gjyqtarët në skemë delegimi.

Në Kreun II të projektvendimit, titulluar "Kuadri ligjor", janë listuar aktet ligjore sipas të cilit do të interpretohet dhe zbatohet projektvendimi.

Ndërsa në Kreun III të projektvendimit, titulluar "Përkufizimet", jepen përkufizimet që do të kenë termat e përdoruara në projektvendim.

Në Kreun IV të projektvendimit, titulluar "Rregulla të përgjithshme të procedurës së lëvizjes paralele", përcaktohen rregullat e përgjithshme që ndiqen gjatë zhvillimit të procedurës së lëvizjes paralele. Ky Kre ndahet në 7 seksione (A, B, C, Ç, D, DH dhe E).

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar "Hapja e procedurës", përcakton fillimin e procedurës nëpërmjet hapjes së saj. Në respektim të përcaktimit ligjor është parashikuar që Këshilli organizon, të paktën çdo tre muaj, procedurën e lëvizjes paralele në gjykata të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ, të shkallës së parë dhe/ose të shkallës së dytë, për çdo pozicion të lirë ose që pritet të bëhet i lirë. Megjithatë, pasur parasysh se pozicionet e lira apo ato që priten të lira, varen nga një sërë rrethanash, që jo gjithmonë krijohen brenda 3 muajve, në këtë pikë të projektvendimit është parashikuar edhe përjashtimi kur Këshilli është në pamundësi objektive për të respektuar këtë rregull e më konkretisht kur: a) nuk ka pozicion të lirë ose b) kjo mund të passjell cenim të rëndë të funksionalitetit të gjykatave. Për rastin përjashtimor sipas shkronjës "b", Këshilli mund: a) të organizojë procedurën e lëvizjes paralele vetëm për disa nga pozicionet e lira ose b) të shtyjë organizimin e procedurave të lëvizjes paralele për të gjitha pozicionet e lira deri në verifikimin e situatës së moscenimit të rëndë të funksionalitetit të gjykatave.

Në vijim, në respektim të kompetencave që ka, është pikërisht Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ai që bën propozimin për shpalljen e procedurës së lëvizjes paralele për çdo pozicion të lirë dhe është Këshilli ai që merr vendim në lidhje me hapjen e procedurës. Komisioni identifikon pozicionet e lira apo që pritet të bëhen të lira brenda tre muajve, duke mbajtur

parasysh se pozicioni i lirë në gjykatën e shkallës së parë është ai pozicion që nuk mund të plotësohet sipas përcaktimeve të nenit 42, pika 3, shkronja b) e Ligjit për Statusin dhe nenit 59, pika 7 të po këtij ligji, ndërsa pozicion i lirë në gjykatën e shkallës së dytë është ai pozicion që nuk mund të plotësohet sipas përcaktimeve të nenit 42, pika 3, shkronja a), nenit 42, pika 3, shkronja b) dhe nenit 59, pika 7 e Ligjit për Statusin. Në vendimin e hapjes së procedurës së lëvizjes paralele, Këshilli përcakton fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë apo që pritet të bëhet i lirë, pasi merr paraprakisht edhe mendimin e Këshillit të Gjykatës përkatëse. Në këtë vendim Këshilli përcakton edhe: a) kriteret ligjore të kandidimit; b) afatin e kandidimit, i cili mund të jetë nga dy deri në katër javë nga data e shpalljes së procedurës; c) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit; ç) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

Seksioni B i këtij Kreu, titulluar “Kandidimi”, përcakton rregullat mbi kandidimin. Në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë mund të kandidojë çdo gjyqtar, i cili gjatë pesë viteve të fundit ka të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës për pozicionin e lirë dhe nuk ka në fuqi një masë disiplinore.

Në pikën 13 të projektvendimit është përcaktuar se në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë në gjykatat e shkallës së dytë të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ, mund të kandidojë edhe gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ose administrativ, i cili nuk ka në fuqi masë disiplinore, si dhe plotëson njërin prej kritereve të mëposhtme: a) është vlerësuar, të paktën dy herë, me vlerësim jo më të ulët se “shumë mirë”, në dy vlerësimet e fundit, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin; b) ka shërbyer në skemë delegimi për të paktën katër vjet dhe gjatë kësaj periudhe është caktuar, të paktën për një vit, në një pozicion në nivel apeli, si dhe ka përvojë profesionale, sipas parashikimit të nenit 47, pika 4, të Ligjit për Statusin.

Në këtë Seksion përcaktohet edhe numri i kandidimeve të vlefshme që mund të kandidojë një kandidat, i cili është tre dhe detyrimin e kandidimit që në rast të kandidimit për më shumë se një pozicion të lirë, të bëjë renditjen sipas preferencës. Ndërkohë, është rregulluar edhe situata e kandidimit në më shumë se tre pozicione të lira në proces, duke përcaktuar rregulla se cilat do të jenë kandidimet e pranueshme për shqyrtim.

Seksioni C i këtij Kreu, titulluar “Fazat e procedurës së lëvizjes paralele”, përcakton fazat e procedurës së lëvizjes paralele. Duke pasur parasysh procesin që duhet të ndiqet në këtë rast, që

finalizohet me përzgjedhjen e kandidatit të renditur më lart dhe transferimin e tij, ndarja në faza është si vijon: a) në fazën e parë bëhet verifikimi i kandidatëve për plotësimin e kritereve ligjore të kandidimit; b) në fazën e dytë bëhet renditja e kandidatëve të kualifikuar dhe c) në fazën e tretë merret vendimi për transferimin e kandidatit të renditur më lart.

Në pikën 19 të projektvendimit është përcaktuar se për çdo procedurë lëvizje paralele caktohet një relator me short, pasur parasysh që në këtë procedurë, në ndryshim nga ngritja në detyrë, nuk ka verifikim të kritereve ligjore sipas vendimit nr. 75, datë 23.05.2019, "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", ndërkohë që në këtë procedurë ndërthuret vetëm procedura e vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve, që në këtë rast zhvillohet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Seksioni Ç i këtij Kreu, titulluar "Të drejtat e kandidatit", përcakton të drejtat që ka kandidati në një procedurë lëvizjeje paralele, duke vënë theksin këtu që në këtë procedurë kandidati ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit etik dhe profesional me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Këtë të drejtë për vlerësim e ka edhe kandidati i komanduar, të cilit, gjatë apo në përfundim të komandimit, nuk i është bërë vlerësimi etik dhe profesional nga institucioni ku ai është komanduar dhe në këtë rast ai vlerësohet për aftësitë profesionale si kandidati jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49, të Ligjit për Statusin, për aq sa gjejnë zbatim, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Kandidati i riemëruar, i cili nuk ka një vlerësim etik dhe profesional si gjyqtar ose nuk ka një vlerësim profesional në momentin e riemërimit, nëse ka ushtruar këtë detyrë përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, ka të drejtë që, në momentin e kandidimit për lëvizjen paralele, të kërkojë kryerjen e vlerësimit me procedurë të përshpejtuar, sipas parashikimeve të nenit 97 të Ligjit për Statusin dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Nëse kandidati nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit përgjatë gjithë vitit të fundit kalendarik, si dhe nëse para kandidimit ka jo më pak se një vit përvojë profesionale, ai ka të drejtë të kërkojë të vlerësohet për aftësitë profesionale sipas parashikimeve të nenit 49, të Ligjit për Statusin, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Seksioni D i këtij Kreu, titulluar "Afatet dhe llogaritja e tyre", përcakton pikërisht rregullat në lidhje me afatet në procedurat e lëvizjes paralele dhe sesi llogariten ato. Në Seksionin DH të këtij Kreu, titulluar "Njoftimet", jepen rregullat në lidhje me njoftimet gjatë zhvillimit të procedurës. Ndërsa në Seksionin E të këtij Kreu, rregullohet "Dorëheqja dhe përjashtimi për shkak të konfliktit të interesit".

Kreu V i projektvendimit, titulluar "Faza e parë e procedurës së lëvizjes paralele", është i ndarë në 6 Seksione (A, B, C, Ç, D dhe DH).

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar "Fillimi i procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe caktimi i relatorit", rregullon pikërisht fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve dhe caktimin e relatorit.

Seksioni B i këtij Kreu, titulluar "Identifikimi i kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale", rregullon mënyrën sesi relatori bën identifikimin e kandidatëve sipas numrit të vlerësimeve etike dhe profesionale. Në numrin e vlerësimeve llogariten edhe kërkesa për vlerësim të përshpejtuar, vlerësimi sipas nenit 49 të Ligjit për Statusin, në përputhje me pikat 26 dhe 27, të projektvendimit.

Fillimisht, procedura e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale.

Në rastin kur për pozicionin e lirë në një gjykatë të shkallës së dytë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kritereve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët sipas shkronjës "a", të pikës 13, pra për ata që kanë një vlerësim etik dhe profesional. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për këtë kategori kandidatësh, atëherë ajo vazhdon për kandidatët sipas shkronjës "b", të pikës 13, të projektvendimit, që është për ata që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë edhe për këtë kategori kandidatësh, është parashikuar që në këtë rast procedura të konsiderohet e përfunduar dhe pozicioni rishpallet përsëri.

Në rastin kur për pozicionin e lirë në një gjykatë të shkallës së parë nuk ka kandidatë që kanë apo mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale, ose kur kandidatët e kësaj kategorie janë tërhequr nga kandidimi, ose kur ata nuk janë kualifikuar për mosplotësim të kritereve të kandidimit, procedura e lëvizjes paralele vazhdon për kandidatët që kanë apo mund të kenë një

vlerësim etik dhe profesional. Nëse për të njëjtat arsye procedura e lëvizjes paralele nuk mund të vazhdojë për këtë kategori kandidatësh, atëherë ajo vazhdon për kandidatët që nuk kanë asnjë vlerësim etik dhe profesional. Nëse për të njëjtat arsye procedura edhe në këtë rast nuk mund të vazhdojë edhe për këtë kategori kandidatësh, atëherë ajo konsiderohet e përfunduar dhe pozicioni rishpallet përsëri.

Seksioni C i këtij Kreu, titulluar "Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit" liston veprimet procedurale dhe verifikuese që bën relatori gjatë procedurës. Në përfundim të procedurës së verifikimit nga relatori, vijon shqyrtimi i çështjes nga Komisioni (Seksioni Ç) dhe më tej shqyrtimi i çështjes nga Këshilli (Seksioni D). Në Seksionin DH të këtij Kreu, titulluar "Vendimi i verifikimit dhe e drejta e ankimit", përcaktohet se vendimi i verifikimit, i marrë në përfundim të kësaj faze të procedurës, arsyetohet sipas kërkesave të nenit 99 të Kodit të Procedurave Administrative, në formën dhe përmbajtjen e aktit administrativ. Në këtë Seksion rregullohet mënyra e njoftimit të vendimit kandidatit, e drejta e ankimit në rast se është vendosur skualifikimi i tij dhe detyrimi i Këshilli për të rishikuar vendimin e tij, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës në rast të pranimit të ankimit të kandidatit. Ndërsa, vendimi i Këshillit për përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për kandidatin që tërhiqet nga kandidimi, është i paankimueshëm.

Në Kreun VI të projektvendimit, titulluar "Faza e dytë e procedurës së lëvizjes paralele", rregullohet në mënyrë të hollësishme kjo fazë. Ky Kre është i ndarë në 8 Seksione (A, B, C, Ç, D, DH, E dhe Ë). Faza e dytë e procedurës së lëvizjes paralele është konceptuar në tre hapa, pasur parasysh përcaktimet e nenit 43, pikat 7, 8 dhe 9 të Ligjit për Statusin.

Seksioni A i këtij Kreu, titulluar "Fillimi i procedurës së përzgjedhjes", rregullon fillimin e kësaj procedure, e cila fillon menjëherë pas përfundimit me vendim të formës së prerë të verifikimit të të gjithë kandidatëve për pozicionin e lirë dhe, kur është rasti, edhe të vlerësimit etik dhe profesional të tyre.

Në Seksionin B të këtij Kreu, titulluar "Hapat e renditjes së kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale", përcaktohen hapat e renditjes së kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale. Për renditjen e kandidatëve me dy vlerësime etike dhe profesionale ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pika 7, të Ligjit për Statusin, si dhe të

detajuara në projektvendim. Hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta.

Vetë Seksioni B i këtij Kreu, ndahet në tre nënndarje të mëtejshme, të numërtuara B.1, B.2 dhe B.3.

Në Nënseksionin B.1 janë përcaktuar renditja dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë. Renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart.

Në rastin e kandidatit të komanduar, niveli i vlerësimit etik dhe profesional i institucionit ku është komanduar, njihet si nivel vlerësimi edhe në kuptim të këtij projektvendimi, duke mbajtur në konsideratë në këtë rast nivelet e vlerësimit të institucionit sipas ligjit të tij të posaçëm dhe nivelet e vlerësimit sipas sistemit të kohës për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve.

Në rastin e kandidatit të komanduar, vlerësimi për aftësitë profesionale të të cilit kryhet nga Këshilli si për kandidatin jogjyqtar në Gjykatën e Lartë, sipas parashikimeve të nenit 49 të Ligjit për Statusit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, nivelet e vlerësimit sipas pikëve që pasqyrohen sipas tabelës në pikën 81 të projektvendimit.

Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

a) “niveli i vlerësimit të fundit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;

b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

Pasur parasysh përcaktimin e nenit 43, pika 7, shkronja a), nënparagrafi i), të Ligjit për Statusin, sipas të cilit përvoja në pozicionet e komanduara dhe si magjistrat në skemën e

delegimit do të konsiderohet një vlerë e shtuar, si dhe diskutimet në grupin e punës gjatë hartimit të projektvendimit në lidhje me këtë përcaktim ligjor, janë propozuar dy variante për rastet se kur do të konsiderohet kjo përvojë si përparësi. Sipas Variantit të Parë është konsideruar si e tillë përvoja si gjyqtari i komanduar dhe në skemën e delegimit, ndërsa në Variantin e Dytë përveç tyre është përfshirë edhe përvoja si anëtar i Këshillit. Kjo e fundit, është propozuar nisur nga interpretimi sistematik i një sërë dispozitash të Ligjit për Statusin, referuar të cilave, përparësi në karrierë, përveç përvojës si i komanduar dhe në skemën e delegimit, konsiderohet edhe qenia anëtar i Këshillit. Gjithsesi, mbetet që Këshilli të diskutojë dhe vendosë për njërin nga variantet e propozuara për pikën 83 të projektvendimit.

Sa i përket përvojës si i komanduar, sipas projektvendimit ajo do të konsiderohet përparësi vetëm në ato raste kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit, në përputhje kjo me përcaktimin e bërë në nenin 57, pika 3 , të Ligjit për Statusin.

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive sikurse më sipër (pikës 82 të projektvendimit) ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli. Sipas kriterit të renditjes të parashikuar sipas skemës së pikëve, të këtij projektvendimi, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në dy vlerësimet e mëparshme etike dhe profesionale, renditet më lart.

Në Nënseksionin B.2, titulluar "Kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e dytë", përcaktohet se në rast se pas vlerësimit të bërë sipas Nënseksionit B.1, të këtij Kreu, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë dhe kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart.

Në Nënseksionin B.3, titulluar "Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e tretë", përcaktohet se në rast se pas vlerësimit të bërë edhe sipas Nënseksionit B.2, të këtij Kreu, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

Seksioni C i Kreut VI, titulluar "Hapat e renditjes së kandidatëve me një vlerësim etik dhe profesional", përcakton që edhe në këtë rast, për renditjen e kandidatëve me një vlerësim etik dhe profesional ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7 dhe 8,

të Ligjit për Statusin, si dhe të detajuara më poshtë në projektvendim, ndërsa hapi pasues i renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të hapit paraardhës nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta. Vetë Seksioni C është i rregulluar në tre ndarje të mëtejshme, konkretisht C.1, C.2 dhe C.3.

Në Nënseksionin C.1, titulluar "Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë" referuar përcaktimit të nenit 43, pika 8 të Ligjit për Statusin, përcaktohet se renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar njëkohësisht në vlerësimin krahasues të: a) rezultatit të vlerësimit etik dhe profesional përkatës; b) renditjes në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e gjyqtarit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Për kandidatin e komanduar dhe, kur është rasti, edhe atë të riemëruar, sa i përket vlerësimit etik dhe profesional, zbatohen të njëjtat rregulla që zbatohet në rastin e kandidatëve me dy vlerësime. Kandidati me rezultatet më të larta sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, renditet më lart.

Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

a) "niveli i vlerësimit etik dhe profesional" - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka nivelin më të lartë të vlerësimit etik dhe profesional, sipas shkronjës "a", të pikës 91, të këtij vendimi, renditet më lart;

b) "përvoja si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit" - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

c) "kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit" - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

ç) "shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit" - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

Në pikën 95 të projektvendimit, në lidhje me përvojën, përcaktohet si e tillë vetëm ajo si i komanduar ose si magjistrat në skemën e delegimit, ndërsa nuk ka diskutim të përfshihet edhe përvoja si anëtar i Këshillit në kushtet kur për t'u zgjedhur si i tillë, ligji përcakton si kusht pasjen 10 vjet përvojë profesionale si gjyqtar, çka teorikisht, sipas Ligjit për Statusin, do të thotë se ai ka tre vlerësime etike dhe profesionale, pra jo një vlerësim.

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive si më sipër, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet: a) në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli; b) në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.

Sipas kriterit të renditjes të parashikuar sikurse më sipër, kandidati me totalin më të lartë të pikëve në vlerësimin etik dhe profesional dhe në vlerësimin përfundimtar të Shkollës së Magjistraturës, renditet më lart.

Nënseksioni C.2, titulluar "Kriteri dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e dytë", përcakton se nëse pas vlerësimit të bërë sipas Nënseksionit C.1, të këtij Kreu, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë. Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart.

Në Nënseksionin C.3, titulluar "Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e tretë", përcaktohet se në rast se pas vlerësimit të bërë edhe sipas Nënseksionit C.2, të këtij Kreu, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

Seksioni Ç i Kreut VI, titulluar "Hapat e renditjes së kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional", përcakton se për renditjen e kandidatëve pa asnjë vlerësim etik dhe profesional për pozicionet e lira në gjykatën e shkallës së parë ndiqen deri në tre hapa, ku në secilin prej tyre bëhet një vlerësim krahasues i treguesve të kritereve dhe përparësive të përcaktuara dhe të renditura në nenin 43, pikat 7, 8 dhe 9, të Ligjit për Statusin dhe të detajuara në projektvendim. Ky seksion ndahet në një Nënseksion Ç.1, titulluar "Kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve për hapin e parë", që përcakton se kandidatët pa asnjë vlerësim etik dhe profesional renditen duke u bazuar në renditjen në listën e të diplomuarve në Shkollën e Magjistraturës ose në vlerësimin profesional në rastin e magjistratit të riemëruar sipas nenit 36 të Ligjit për Statusin. Sipas këtij kriteri, kandidati me rezultatet më të larta, renditet më lart.

Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

a) "përvoja si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit" - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart;

b) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart;

c) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit” - Sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart.

Në pikën 104 të projektvendimit, në lidhje me përvojën si i komanduar ose si gjyqtar në skemën e delegimit edhe në këtë rast konsiderohet përparësi për lëvizjen paralele.

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive të sipërcituara, të këtij projektvendimi, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vlerësimin përfundimtar me pikë të bërë nga Shkolla e Magjistraturës pas vitit të tretë të programit të formimit fillestar.

Në Seksionin D të Kreut VI, titulluar “Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit”, rregullohen veprimet që kryen relatori në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për lëvizjen paralele, si dhe rregullat e zbatueshme janë ato sipas neneve 54, 55, 59 dhe 60 të projektvendimit.

Në Seksionin DH të këtij Kreu, titulluar “Shqyrtimi nga Komisioni i projektvendimi të renditjes së kandidatëve”, përcaktohet se për shqyrtimin nga Komisioni të projektvendimit të renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 61, 62 dhe 63, të projektvendimit.

Në seksionin E të këtij Kreu, titulluar “Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit të renditjes së kandidatëve”, përcaktohet se për shqyrtimin nga Këshilli të projektvendimit të renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 64, 65, 66, 67 dhe 68, të projektvendimit.

Në Seksionin Ë të këtij Kreu, titulluar “Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe e drejta e ankimit”, përcaktohet se për vendimin e renditjes së kandidatëve janë të zbatueshme rregullat sipas pikave 70, 71, 72 dhe 73, të projektvendimit.

Në Kreun VII të projektvendimit, titulluar “Faza e tretë e procedurës së lëvizjes paralele”, përcaktohet se jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë lëvizjeje paralele, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori, Këshilli merr vendim për transferimin në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart. Vendimi i Këshillit i njoftohet gjyqtarit të transferuar, gjykatave respektive, si dhe bëhet publik

në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Një kopje e vendimit bëhet pjesë e dosjes personale të gjyqtarit të transferuar.

Së fundmi, në Kreun VIII, titulluar "Dispozita për periudhën kalimtare", projektvendimi parashikon se gjatë periudhës kalimtare sipas nenit 25, paragrafi 3, të Ligjit nr. 48/2019, për renditjen e kandidatëve në një procedurë përzgjedhjeje për procedurat e transferimit paralel zbatohen rregullat sipas Kreut VI të Projektvendimit, përveç sa parashikohet në Seksionin A të këtij Kreu.

Ndërsa Seksioni B i këtij Kreu, titulluar "Për kandidatët me dy vlerësime etike dhe profesionale", në lidhje me kriterin e renditjes së "dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale", si dhe se cili do të konsiderohet si vlerësim i parë dhe i dytë për efekt të këtij kriteri, ai bën të njëjtin rregullim sikurse edhe dispozita për periudhën kalimtare në Vendimin e Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, "Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve".

Ndërkohë, në Seksionin C të këtij Kreu janë bërë rregullime edhe për kandidatët që janë me një vlerësim etik dhe profesional, duke përcaktuar se cili do të konsiderohet vlerësim etik dhe profesional sipas shkronjës "a", pika 91, të projektvendimit, kjo në rastin e kandidatit që ka ushtruar funksionin e gjyqtarit gjatë vitit të fundit kalendarik, kandidatit që ka qenë në një pozicion të komanduar prej jo më pak se viti të fundit kalendarik nga momenti i kandidimit për lëvizjen paralele, si dhe kandidatit të riemëruar, i cili nuk ka një vlerësim profesional në momentin e riemërimit, nëse ka ushtruar detyrën e gjyqtarit përgjatë të gjithë vitit të fundit kalendarik. Ky është në mënyrë të përmbledhur relacioni në lidhje me projektvendimin.

Do desha të sjell në vëmendjen tuaj, pika 83 e projektvendimit, Komisioni ka konsideruar ta paraqesë në dy variante dhe Këshilli do duhet të konsiderojë njërin prej tyre paraprakisht. Po kështu do dua të sjell në vëmendjen tuaj se për shkak të pakujdesisë, në pikën 115, 119 dhe 121 ka një lapsus, është togfjalëshi "mbi kërkesën e tij", që s'duhet ta konsideroni sepse nuk përputhet me rregullimin e të gjithë dispozitës, ndërsa sipas nenit 22, Kreu 5, të vendimit të Këshillit nr. 263, datë 21.11.2019 "Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve", vlerësimi i përshpejtuar në këtë rast është i detyrueshëm pra dhe jo me kërkesë të kandidatit. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, z. Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

***Alban Toro***: Po! Të lutem, mund të flas?

***Naureda Llagami***: Po!

***Alban Toro***: Ndoshta Iliri, për nga modestia ka dëshiruar ta bëjë me dy variante, ndërkohë që një pjesë ose të themi të paktën pjesa e jogjyqësorit duhet të shprehet në lidhje me pikën 83.

Të qenurit anëtar i Këshillit normalisht është vlerë e shtuar dhe ne nuk kemi pse duhet t'i ndajmë në alternative dhe të konsiderojmë të qenit apo të mosqenit të përfshirë në këtë draft fakti që anëtari i Këshillit është vlerë e shtuar, dhe në këtë kuadër unë mendoj që varianti i dytë është më i përshtatshëm dhe përfshin edhe qëllimin e ligjit, i cili në disa momente e ka parashikuar që anëtari i Këshillit është vlerë e shtuar në lidhje me gjyqtar kur pretendohet ngritje në detyrë e tyre, për t'u marrë në konsideratë në vlerësimin, kur ata i nënshtrohen vlerësimit nga sektori përkatës.

Kështu që unë jam për variantin e dytë (83 Varianti i dytë) dhe jam dakord me të gjithë draftin tjetër. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit Alban, për qëndrimin!

Ndonjë diskutim tjetër përpara se ta hedhim në votim, në mënyrë të posaçme për nenin 83 sipas varianteve të propozuara nga Komisioni.

***Brikena Ukperaj***: Edhe unë doja të shprehja dakordësinë time për të gjithë përmbajtjen e rregullores, edhe për saktësimet e bëra nga Kryetari i Komisionit të Karrierës. Edhe unë ndaj të njëjtin qëndrim si zoti Toro, lidhur me variantin e dytë të propozuar nga Komisioni. Por ka një sugjerim lidhur me një ndryshim të formulimit vetëm të një pikë në rregullore, që nuk ka të bëjë në fakt me përmbajtjen e rregullores, por ka të bëjë me procedurën e votimit në mbledhje plenare. Është konkretisht Kreu D, pika 68. Ky parashikim, sikundër është paraqitur në projektrregullore, është i ndryshëm nga propozimet që Komisioni i Karrierës na ka bërë dhe që ne i kemi miratuar në Këshill në fakt, lidhur me rregulloret e tjera që kanë të bëjnë me verifikimin e kandidatëve për ngritjen në detyrë apo për rastin e pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, apo edhe për rastin e kandidatëve jogjyqtarë për Gjykatën e Lartë. Konkretisht, në nenin 68 parashikohet që (lexohet): "63. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli vendos për miratimin e projektvendimit të verifikimit të kandidatit sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime, sipas propozimit të çdo anëtari. Votimi nga anëtarët bëhet në të njëjtën kohë

me përjashtim të rastit kur kjo është e pamundur.” Ky është një parashikim i ri në fakt, që vjen me anë të kësaj rregulloreje për mënyrën se si duhet të votojmë ne në rastet e akteve administrative individuale që lidhen me gjithë procedurën e lëvizjes paralele.

Në kushtet kur nuk e kemi miratuar akoma rregulloren e brendshme, që mendoj që do të jetë akti final që do të finalizojë mënyrën se si duhet të votohet në mbledhjen plenare, mendoj që ky parashikim i bërë në këtë rregullore të ndryshohet, për të ruajtur të njëjtin standard siç kemi tani në çdo rregullore tjetër që ka të bëjë pikërisht me akte administrative individuale gjatë procedurave të ngritjes në detyrë apo atyre të verifikimit.

Konkretisht propozoj që të kemi të njëjtën mënyrë votimi, për të ruajtur të njëjtin standard, sikundër kemi parashikuar edhe në rregulloren e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, ku kemi parashikuar se në përfundim të bisedimeve për zgjidhjen e çështjes, i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, më tej anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund Kryetari i Këshillit. Pastaj le të vazhdohet me propozimin që në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit dhe kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese. Ky ishte propozimi im për ndryshimin e mënyrës së votimit në mbledhje plenare.

***Naureda Llagami***: Faleminderit, Brikena!

***Ilir Toska***: Mund të flas?

***Naureda Llagami***: Po, patjetër!

***Ilir Toska***: Është shumë korrekte ajo që tha zonja Ukperaj që ne në disa rregullore të tjera kemi parashikuar një mënyrë tjetër të votimit të projektvendimeve. Është e vërtetë po ashtu që ky rregull në fakt është një rregull që ne duhet ta ndjekim në çdo lloj procedure ku duhet të miratojmë akte akte administrative individuale për gjyqtarët apo nëpunësit civilë gjyqësorë, që përfshihen në rrethin e subjekteve që trajtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Nuk kam asnjë kundërshtim që në fakt do duhet që ne ta unifikojmë procedurën e votimit, as kam kundërshtim që kjo është një çështje që i përket rregullores së brendshme.

Në fakt, qëllimi i projektvendimit që kemi sot për shqyrtim nuk është të rregullojmë mënyrën e votimit. Kjo është vendosur thjesht për të mbyllur të gjithë ciklin, meqenëse janë parashikuar edhe rregulla procedurale. Nuk kam asnjë kundërshtim nëse mendoni se do duhet ta

zgjidhim rastin me një rregullim të bërë në rregulloren e brendshme të Këshillit. Të hiqet fare fjalia e dytë dhe bën sens i gjithë rregulli parashikuar në nenin 68, dhe ta vendosim pastaj kur të miratojmë rregulloren e brendshme edhe mënyrën e votimit. Nuk ka nevojë të vendosim prapë një rregull që mund të ketë diskutime prapë. E heqim fjalinë e dytë, se vetëm fjalia e dytë parashikon një mënyrë të caktuar votimi, e lëmë të hapur atë dhe procedojmë, sipas praktikës që ndjekim dhe mund të vazhdojmë më tej.

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, për procedurë, hedhim në votim, përpara se ta kalojmë rregulloren në tërësi, variantet e nenit 83 dhe më pas kalojmë në votim edhe riformulimin e nenit 68, sipas propozimit të bërë nga zonja Ukperaj dhe të pranuar nga zoti Toska. Jemi dakord? Më pas kalojmë rregulloren në tërësi.

Meqë dy nga kolegët ishin dakord me Variantin e dytë, e hedhim, në votim dhe më pas me Variantin e parë të nenit 83. Kështu që, jemi dakord me Variantin e dytë të nenit 83?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Këshilli miratoi Variantin e dytë të nenit 83, që do të thotë që përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit konsiderohet si përparësi në renditje sipas pikës 83, të këtij vendimi, vetëm në ato raste kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit ose të mandatit. Gjyqtari konsiderohet se ka kryer të gjithë periudhën e komandimit edhe në rastin kur Këshilli, kryesisht, për shkaqe të shpallura në momentin e komandimit, ka përfunduar komandimin e tij para afatit.

Kalojmë në propozimin e dytë që është riformulimi i bërë për nenin 68, iniciuar nga zonja Ukperaj dhe pranuar nga zoti Toska, që të hiqet fjalia e dytë e këtij neni. Jemi dakord?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Kundër.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord. Është paragrafi i dytë dhe i tretë. Votimi dhe mënyra si voton, vota e Kryetarit. Mendoj që këto janë pjesë e rregullores së brendshme që do miratojmë.

***Marçela Shehu***: Kundër. Në fakt kjo është edhe fryma dhe ajo çka ka parasysh edhe grupi i punës që po punon me rregulloren e brendshme dhe pasqyrimi në këtë rregullore sot është pak a shumë i njëjti pasqyrim tek ajo që është pasqyruar në rregulloren e brendshme, megjithëse nuk është miratuar akoma nga Këshilli. Kështu që unë, gjithsesi nuk shikoj asnjë problem që ne këtë ndryshim ta fillojmë që në këtë rregullore, për ta pasqyruar mbase më vonë edhe në të gjitha rregulloret e tjera, siç është ajo e verifikimit, që lidhet me vendimin nr. 75 të Këshillit. Kështu që unë jam kundër këtij propozimi.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e bërë nga zonja Ukperaj dhe pranuar nga zoti Ilir Toska.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektrregullores.

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord. Vetëm kundër lidhur me atë propozimin që u kalua pastaj me shumicë.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projektvendimin "Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve", sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe propozimet e ardhura nga anëtarët.

*  *  *

(Pika e 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata" i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore Fatmira Luli).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami (kryetare)***
2. ***Maksim Qoku (zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici (anëtar)***
4. ***Fatmira Luli (anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi (anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj (anëtar)***
7. ***Ilir Toska (anëtar)***
8. ***Alban Toro (anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj (anëtar)***
10. ***Marçela Shehu (anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj (anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata" i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit (relatore Fatmira Luli).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila edhe kjo është një çështje jo më pak e rëndësishme, bëhet fjalë për projektvendimin "Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Ky është një projekt-akt shumë i rëndësishëm. Projekt-akti është i përgatitur nga Komisioni dhe është pjesë e një set aktesh që ne duhet të shqyrtojmë dhe miratojmë në vazhdim lidhur me administratën gjyqësore.

Projekti në fjalë ka përcaktuar në detaje të gjithë procedurat dhe kriteret për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor punonjësve që janë në detyrë në gjykata.

Për më shumë detaje, dëshiroj t'ia jap fjalën relatores znj. Fatmira Luli.

***Ilir Toska***: Më falni, mund ta marrë fjalën për procedurë?

***Naureda Llagami***: Po!

***Ilir Toska***: Unë jam njohur me materialin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit dhe me relacionin e tij. Në relacion kam konstatuar që ligji dhe menjëherë pas miratimit të këtij akti nënligjor nga ana e Këshillit do të zbatohet

menjëherë, do të prekë, sipas relacionit, 63 nëpunës sot në gjykata, të cilët sipas relacionit nuk plotësojnë kriteret formale që parashikon ligji i ri në fuqi.

Në fakt, unë do të kisha nevojë që të kishim një panoramë të të gjithë pozicioneve në çdo gjykatë ku janë këto 63 punonjës, që të kuptojmë situatën që mund të na krijohet në gjykata të ndryshme, ku për shkak të zbatimit të ligjit dhe mosplotësimit nga ata të kritereve, do të krijohen vakanca të cilat, nëse nga të dhënat do të jenë gjykata që mund të krijohet dhe ta çojnë në kolaps, ne do duhet të mendojmë një zgjidhje. Prandaj do të propozoja që ta shtyjmë shqyrtimin e këtij projektvendimi në një seancë më të afërt, por paraprakisht të na jepen të dhëna të detajuara për gjykatat ku janë 63 punonjësit të cilët nuk plotësojnë kriteret formale të ligjit, që të kuptojmë nëse do të mundemi të bëjmë një zgjidhje për të mos i çuar ato drejt bllokimit. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, është me të drejtë kjo që ju ngrini.

Ne mund të kemi të dhëna por për efekt që ju të reflektoni mbi këto të dhëna, unë jam gati që ta parashtroj propozimin tuaj. Nëse janë dakord anëtarët, këtë projekt-akt mund ta kalojmë për shqyrtim në mbledhjen e radhës dhe ndërkohë nga stafi administrativ t'ju përcillet informacioni që ju kërkoni.

Jemi dakord?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, nga stafi administrativ, të merren masa, që brenda ditës së sotshme t'i jepet informacion të gjithë anëtarëve mbi situatën dhe pasojat që mund të krijojë në të ardhmen ky projekt-akt. Projekt-akti shtyhet për mbledhjen e radhës.

*          *          *

(Pika e 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot.                                                         Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e sistemit elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë".

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e sistemit elektronik të Organizatave Jofitimprurëse, për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë".

***Naureda Llagami***: Kalojmë tek çështja tjetër e rendit të ditës, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve në investime për realizimin e sistemit elektronik te Organizatave Jofitimprurëse...". Shkurtimisht, ky projektvendim vjen në kuadër të dy kërkesave që na ka përcjellë Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, ku ka sjellë dy shkresa dhe ky institucion ka informuar se Shqipëria është listuar nga "Task Force" e Veprimit Financiar Ndërkombëtar në listën e vendeve gri, për shkak të mungesës së transparencës të OJF-ve, të regjistrit të Organizatave Jofitimprurëse.

Me këtë qëllim, është shumë e rëndësishme që ky regjistër të jetë "online" sipas rekomandimeve dhe për këtë janë bërë edhe ndryshimet në legjislacionin përkatës.

Më shumë lidhur me pjesën e buxhetit unë do të ftoja Drejtoreshën e Departamentit të Administrimit të Buxhetit, znj. Laze, që të relatojë projekt-aktin në fjalë.

***Luljeta Laze***: Përshëndetje të gjithëve!

Për të vijuar me këtë shpjegim që sapo bëri Kryetarja, pikërisht Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, nëpërmjet 2 shkresave të saj, që janë nr. 463, datë

12.05.2020 dhe nr. 463/2, datë 05.06.2020, ka informuar se në kuadër të listimit të Shqipërisë në grupin e vendeve në monitorim të shtuar nga Task Force Ndërkombëtare është hartuar një plan veprimi për vënien në zbatim të të cilit është e domosdoshme që Shqipëria të krijojë një mekanizëm ligjor që siguron që të dhënat e regjistruara në përputhje me detyrimet e transparencës ligjore, të jenë të përditësuara dhe të verifikohen në mënyrën e duhur si nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ashtu edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu në këto shkresa theksohet se ngritja në një kohë sa më të shpejtë të këtij regjistri, mundësisht brenda muajit shtator do të jetë një arritje për përmbushjen e qëllimit të përbashkët institucional për të nxjerrë vendin tonë nga lista gri.

Kjo masë kërkon që pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të ngrihet dhe të jetë funksional regjistri elektronik për të gjithë Organizatat Jofitimprurëse të regjistruara pranë kësaj gjykate dhe ky regjistër do të përmbajë informacion ligjor, transparent real të subjekteve/individëve pjesë përbërëse të strukturave drejtuese dhe administruese të këtyre administratave. Ngritja e këtij regjistri dhe hedhja e të dhënave ka si afat tentativë muajin shtator 2020 dhe si afat përfundimtar muajin prill 2021.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, kërkon nga KLGJ, marrjen e masave për mbështetjen financiare si dhe për strukturën që do të bëjë të mundur hedhjen e të dhënave.

Shkresa e ardhur në KLGJ gjithashtu i ka shkuar edhe institucioneve të tjera, midis të tjerave edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila do të jetë përgjegjëse për ngritjen e këtij regjistri elektronik.

Nga ana e saj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, na është drejtuar me një shkresë nr. 2582/2, datë 15.05. dhe i ka kërkuar KLGJ-së miratimin për fillimin e punës për hartimin e këtij regjistri. Nga ana e saj, në mbledhjen e Komisionit të Përhershëm të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, të datës 3 korrik 2020, është vendosur që të miratohet fillimi i punës nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kontrata e shërbimit të vlerësimit të kostos së projektit, të mbulohet nga të ardhurat që realizon vetë gjykata.

Për këtë, i është kthyer përgjigje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka filluar punën dhe me shkresën e saj nr.2582/12, datë 30.07.2020, ka dërguar studimin e vlerësimit të projektit për ngritjen e regjistrit elektronik të Organizatave Jofitimprurëse pranë KLGJ-së. Në këtë studim është parashikuar edhe integrimi me sisteme të tjera sikurse është sistemi i

menaxhimit të çështjeve gjyqësore, që vet gjykata ka, sistemi i Drejtorisë së Përgjithshme të tatimeve, sistemi i Drejtorisë së pastrimit të parave, etj. Vlera e ngritjes së regjistrit elektronik të OJF-ve, e cila shërben si fond limit në prokurimin që do të kryhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është 48,000,000 lekë.

Për sigurimin e fondeve për ngritjen e regjistrit elektronik të OJF-ve, është menduar që të përdoren fondet e mbetura të pashpërndara në investime në programin buxhetor “Buxheti i Gjykatave”, pas rialokimit të fundit për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti. Fondi në dispozicion i mbetur është 40,285,000 lekë. Diferenca prej 7,715,000 lekë mund të transferohet nga fondi i investimeve për projektin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili nuk është realizuar, në fondin e investimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa i takon pikës së dytë që kërkohen në shkresë për mbështetjen e strukturës që do të bëjë të mundur hedhjen e të dhënave, kjo gjë do t’i kërkohet shtesë punonjësit Ministrisë së Financave në negociatat që do kemi për projektbuxhetin e vitit 2021-2023.

Për sa më sipër, në përmbushje të detyrimit institucional për ngritjen për një kohë sa më të shpejtë të regjistrit elektronik të OJF-ve që siguron që të dhënat e regjistruara në përputhje me detyrimet e transparencës ligjore të jenë të përditësuara dhe të verifikohen në mënyrën e duhur nga QKB dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me qëllim për të nxjerrë vendin tonë nga “lista gri”, sugjerojmë transferimin e fondeve në investime, nga fondet e papërdorura të programit buxhetor “Buxheti Gjyqësor” në shumën prej 40,285,000 lekë dhe fondit të parealizuara për projektin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në shumën prej 7,715,000 lekë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

***Naureda Llagami***: Unë do të ftoja kolegët nëse kanë pyetje e diskutime lidhur me propozimin e projekt-aktit.

***Alban Toro***: Mundem?

***Naureda Llagami***: Po, Alban!

***Alban Toro***: Fillimisht unë do të bëja një pyetje, nuk e di kush mund të më kthejë përgjigje nga juve apo Luli, ndërkohë që pastaj do të vijoj me disa vërejtje që kam në lidhje me studimin e paraqitur dhe që suporton faturën ekonomike të këtij sistemi.

Atëherë, nuk e di, nëse këtë fond që ju keni përcaktuar dhe që është i nevojshëm, e keni suportuar nëpërmjet një studimi të përgatitur nga një subjekt i cili është operator në këtë fushë. Këtij studimi i keni bërë oponencë nga burimet tona njerëzore në lidhje me saktësinë, qartësinë, sepse mua më duket, me atë përgatitje të limituar që kam në këtë fushë, kam nxjerrë shumë pikëpyetje të cilat mund të bëjnë që ky sistem të kushtojë më shumë, por mund të kushtojë edhe më pak se sa ajo që është propozuar. Pra nëse ky operator ka kërkuar 80 milion, ne kemi propozuar 77 milion, të reja gjithmonë (sepse vlera e lekut është vetëm një). Kjo vlerë mund të jetë edhe e ulët, por mund të jetë edhe e lartë.

Kështu që, fillimisht do doja të dija nëse kemi ndonjë oponencë nga stafi ynë për këtë studim, nëse shikojnë ndonjë paqartësi apo boshllëk apo diçka që mungon? –dhe pastaj të vijoj më tej.

***Naureda Llagami***: Faleminderit, Alban!

Luli, të lutem, për ty fjala, për të gjitha sqarimet lidhur me procedurat përkatëse që keni ndjekur lidhur me këtë vlerësim.

***Luljeta Laze***: Studimi është kryer sipas procedurës ligjore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kur kryhet studim nga ekspertë të fushës, siç është në rastin tonë që është një kompani përkatëse, nuk mund të bëhet oponencë nga individë. E para njëherë që kjo është një përgjegjësi që ka gjykata dhe jo ne. Nuk mund ta shikojmë ne ekspertizën e dikujt tjetër dhe të hyjmë ne për këtë gjë. Sepse, ashtu sikurse ju e dini, edhe në gjykatë, kur ka paqartësi, në kuptimin e njohjes së fushës, merren ekspertët dhe eksperti vendos dhe ka përgjegjësinë e vet për këtë gjë. Nuk mundemi që t’i hyjmë kësaj gjëje. Neve jo.

Oponencë, me sa unë e di, ligji parashikon vetëm për projektet e ndërtimit që mund të bëhen me një vlerë të caktuar (mbi 100 milion lekë), që bëhen nga Instituti Shtetëror i Ndërtimit. Kurse oponencë për këtë ne nuk e njohim. Nuk di që të ketë në legjislacion kryerja e oponencës kur ato kryhen nga ekspertë të fushës.

***Alban Toro***: Atëherë Luli, unë ndaj opinion krejt të kundërt me juve.

Aktualisht Këshillit i është besuar një pjesë e fondeve publike dhe këto fonde publike ai duhet t’i miradministrojë. Që t’i miradministrojë, ai duhet të identifikojë produktet që kërkohen,

qoftë edhe Gjykata e Tiranës, të jenë të sakta dhe me këtë saktësi të hidhen dhe tenderohen për aq sa kërkohet.

Tani po kaloj tek vërejtjet që unë kam konstatuar, gjithmonë me njohjen time të kufizuar, pavarësisht se unë i përmbahem parimit latin “Sutor, ne ultra crepidam”, që secili duhet të shikojë profesionin e vet dhe të përgjigjet brenda profesionit të vet, por gjithsesi, me këtë përgatitje të kufizuar kam konstatuar disa probleme të cilat mund të kthehen në vlera monetare, por mund të hiqet dhe vlera monetare nga kjo shumë që kërkohet. Pra në këtë kontekst nuk jam dakord me ju, që pretendoni që ne nuk caktojmë dot një ekspert. Eksperti do të ishte personeli i KLGJ-së, i cili do të identifikonte boshllëqet në këtë sistem. Sepse këto boshllëqe, nesër kthehen në vlera monetare që do kërkohen nga personi që do të fitojë tenderin.

Tani, më lejo t’i fillojë me radhë:

Kalojmë tek integrimi i sistemit. Aplikimi për marrjen e personalitetit juridik nga OJF (dhe jep sistemet që do të interferojnë dhe do të ndeshen me sistemin tonë, pra më sistemin e OJF-ve). Pyetja legjitime është: A do të ketë sisteme të tjera të paparashikuara në këtë listim, të cilët personi që do të bëjë softuerin apo që do bëjë programin të dijë, do ta bëjë me “fee”, pa “fee” sepse duke mos e parashikuar sisteme të tjera të cilat ligji për momentin nuk i ka parashikuar, ka parashikuar Gjendjen civile, Policinë, Pastrimin e parave, nesër mund të parashikojë, të themi, KLGJ-në (po marr një rast hipotetik), i cili do të interferojë me këtë sistem, pra do të ndeshet me këtë sistem, se është një sistem në ndeshje, ngaqë interferon me shumë sisteme të tjera. Duke interferuar dhe duke mos u listuar tek lista e subjekteve që kanë të drejtë të interferojnë me këtë sistem, me të drejtë, ai që do ta prodhojë do thotë, dale se unë kam sisteme të listuara të cilat do komunikojnë me sistemin e OJF-ve, dhe ju nuk bëni pjesë në të, kështu që duhet të paguani më tepër. Kjo një, për këtë pjesë.

Vazhdojmë më tutje.

Kalojmë tek objektivat dhe pritshmëritë. Këtu unë nuk kam asnjë lloj nën-detajimi të detyruar, që duhet të ishte, të programeve, të procedurave, të cilat duhet të bëjë ky sistem. E thënë me fjalë të tjera, një “ëorkfloë” të dokumentit, si do fillojë, ku do shkojë, pra që nga skanimi ndërmjet stafit, apo ndërpjet “CD” që do të sjellë subjekti apo ndërmjet “web”-it “online”. Të dyja këto variante pastaj kalojnë nëpërmjet filtrave të tjerë, që do të thotë: Sekretarja ia çon gjyqtarit dhe interferon me CCMIS i cili vendos datën gjyqësore se kur do të zhvillohet, lë detyrat, ia jep këtë detyrë sekretarisë dhe sekretaria njofton subjektin. Pra gjithë ky

bashkëveprim përkthehet në disa faza në të cilat dokumenti duhet të kalojë dhe në fund finalizohet me regjistrimin apo me refuzimin e regjistrimit dhe me shpalljen në "website"-in e OJF-ve. Kjo gjë këtu nuk është parashikuar. Dhe kjo gjë përkthehet gjithashtu në vlerë monetare nesër-pasnesër kur kërkohet për të bërë softuerin. Këtu mos harrojmë edhe gjithë parametrizimin e sistemit, që unë në çdo moment mund t'i kërkoj subjektit që ka prodhuar sistemin pa "fee", të ndryshoj një variacion të sistemit për t'iu përgjigjur nevojës time. Pra që mos të jetë një sistem në gur, që për çdo ndryshim mund të paguaj, por të jetë një sistem i cili t'i përgjigjet ndryshimeve që do të kërkoj unë dhe pa "fee". Edhe kjo përsëri ndikon tek kosto që neve duhet të prokurojmë, jo ne, por që ne duhet të parashikojmë për Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Kalojmë më tutje.

Po shikoj tek tek planifikimi i buxhetit për ndërtimin e sistemit, zotëria ka parashikuar: Implementimin e regjistrit elektronik (pa specifikuar se çfarë është, pa dhënë asnjë referencë se çfarë është); Integrimi me sistemet e treta; Protokollet e sigurisë enkremptimi i të dhënave; Aplikimi GIS, për pozicionin e OJF-ve; Trajnime; Infrastruktura hostuese; Mirëmbajtje.

Le t'i marrim me radhë. Në qoftë se unë kam kriter të veçantë "Protokollin e sigurisë" i cili nga ana tjetër nuk më rezulton se çfarë përfaqëson, që normalisht duhet të ekzistonte se cilët janë këto protokolle sigurie sepse është jashtëzakonisht e rëndësishme një protokoll sigurie në këto faza; në qoftë se unë kam të ndarë "Aplikimin GIS", në qoftë se unë kam të ndarë "Integrimin me sistemet e treta"; atëherë çfarë përfshin Implementimi i regjistrit elektronik? Cili është ai? As këtë nuk e kam.

Vazhdojmë më tutje. "Infrastruktura hostuese", që do të thotë, kjo gjë që do të prodhohet do të flejë diku. Detyrimisht është Gjykata e Rrethit Tiranë ajo që do ta mbajë. Pyetja është: Serveri i Gjykatës së Rrethit Tiranë, a mund ta mbajë këtë pjesë? Ka dy opsione: "Po" ose "Jo". Nëse është "Jo", atëherë do shikohet mundësia që Gjykata e Rrethit Tiranë, në të ardhmen (pra shikohet edhe pak në makro), është nga gjykatat që është më e mjeruar, jo në republikë, por nuk e di me kë ta krahasoj, që normalisht duhet gjendur një zgjidhje që infrastruktura e saj të modernizohet. Nëse modernizohet në të ardhmen, natyrisht do të ketë nevojë për një server të madh ku të përfshihet edhe kjo pjesë e serverit që do të kërkojë të përdori këtë program. Nëse ky opsion është i largët dhe ne nuk kemi mundësi, atëherë ngelet që të marrim përgjigje nëse kjo infrastrukturë aktuale e përmban, mund ta hostojë këtë softuer ose nëse jo pastaj do vlerësohet

për të marrë një server të dytë, i cili nuk e dimë se ku do vendoset në atë gjykatë. Se dakord, po e blejmë, po ku do ta vendosim, për vet limitin që ka ajo gjykatë.

Kalojmë tek "Mirëmbajtja", dhe këtu mos më thoni që unë nuk kam praktika mirëmbajtjeje sepse praktikat mund t'i shikoni tek kontrata që ka lidhur me ICMIS-in Ministria e Drejtësisë me Shoqërinë IKUB. Ka gjysmën e kësaj vlere. Në fund të fundit, çfarë është kjo vlerë 40 milion në vit, dhe për dy vjet e bën 80 milion, 8 milion, - më fal (flas me të reja), -çfarë është kjo gjë e re që do të kërkojë kaq mirëmbajtje?!

Jam dakord me logjikën që është një sistem në ndeshje, pra vazhdimisht interferon me sisteme të tjera, që ne i cituam më përpara, jo Policia, jo Pastrimi i parave, etj., të gjithë do tentojnë që të lidhen me këtë, por çfarë nevoje ka ky produkt i ri për 4 milion në vit, për t'u mirëmbajtur?! Nuk është e parashikuar.

Pra janë ca pikëpyetje që unë si anëtar i Këshillit nuk mund t'i kaloj dot kaq lehtë dhe nuk mund të them që na qenka një person që qenka operator i zoti dhe ka thënë këto gjëra.

Atëherë, këtij zotërisë, ose të paktën stafit tonë mund t'i vinin në dispozicion një kontratë që ka lidhur Ministria e Drejtësisë me Shoqërinë IKUB për sistemin ICMIS që është një sistem jashtëzakonisht i ndërlikuar. Këta kanë ofruar 20 milion, gjysmën e vlerës, për mirëmbajtje. Pra shikojmë pak se ka shumë diferenca. Nuk janë kokrra, qindarka apo lekë të vogla. Janë goxha vlera.

Mos e zgjas më tepër sepse kam akoma edhe më shumë, edhe tek "Sistemi i sigurisë", që unë nuk e di se çfarë përfshin brenda, ndërkohë që duhet të ishin të listuara të gjitha sistemet e sigurisë që ofron ky lloj sistemi, të cilat në fakt konvertohen në lekë nesër-pasnesër. Pra nuk mund të jetë një sistem në gur, është një sistem në zhvilli, dhe si i tillë, unë dua të kem të parashikuar të gjithë detyrimet që ka ai, që ofron për sigurinë.

Që mos ta zgjas dhe mos t'ju lodh kokën. Unë do të propozoja, meqenëse kemi dy partnerë, EURALIUS dhe USAID, cilido nga këta të dy, t'i kërkohet një oponencë se si duhet të jetë ky sistem; nëse ka një studim të shprehur në vlera monetare, se sa duhet të kushtojë ky sistem; dhe nëse mund të na ndihmojë edhe për ta prodhuar, pse jo. Në kuadër të miradministrimit të fondeve publike, ne mund t'i kërkojmë ndihmë që këtë fond që duhet për këtë, ta përballojë një nga këta partnerë, nëse kanë mundësi. Nëse s'kanë mundësi i drejtohemi pastaj zgjidhjes me miratim të buxhetit të kësaj vlere dhe pastaj të prokurohet (si të jenë rregullat).

Pra propozimi është që ne t'i drejtohemi EURALIUS-it në lidhje me një oponencë në lidhje me këtë sistem, duke ia vënë në dispozicion, duke bërë edhe një përcaktim të vlerës që duhet e saktë, dhe njëkohësisht t'i kërkohet nëse mund ta mbulojë një pjesë, apo pjesën totale të vlerës së saj. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Atëherë, faleminderit Alban!

E hedhim në votim propozimin e Albanit për t'ia kaluar për mendim dhe pse jo për të na bërë partnerët/projektet një oponencë, në kushtet që ne nuk e kemi ekspertizën, dhe më pas, nëse ato pranojnë, të vijojmë me alokimin e fondeve.

E hedhim në votim propozimin ose nëse ka ndonjë person tjetër diskutim?

***Marçela Shehu***: Po Kryetare, mundem?

Përpara se të kalojmë në votim, unë në fakt jam dakord me propozimin e Albanit, për t'i marrë një mendim edhe misioneve që na asistojnë, të dyja misioneve si EURALIUS ashtu edhe USAID, duke e konsideruar këtu faktin se në dijeninë time, pranë Misionit EURALIUS ka ekspertë të kësaj fushe, të cilët na kanë asistuar dhe na kanë dhënë mendim herë pas here, ndaj edhe unë do të vlerësoja që përpara se të kalojmë në votimin e projektvendimit që na u propozua, të marrim edhe mendimin e misioneve që me anë të ekspertëve të tyre, besoj do të na ndihmojnë lidhur me këtë çështje. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Okej!

Dakord! E hedhim në votim propozimin.

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Kundër.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, stafi administrativ t'i kalojë për mendim, mundësisht brenda ditës së sotshme, për dhënie oponencë të projektit të propozuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, mbi ngritjen e këtij sistemi, të dy projekteve, dhe USAID "Justice for All" dhe EURALIUS.

* * *

(Pika e 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 5 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime personeli, të programit 3310 “Buxheti gjyqësor””, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime personeli, të programit 3310 "Buxheti gjyqësor"", i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

***Naureda Llagami***: Kalojmë në çështjen tjetër e cila ka të bëjë me miratimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore në shpenzime personeli, të programit 3310 "Buxheti gjyqësor", i përgatitur edhe kjo nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit. Për më shumë detaje ia jap fjalën sërish zonjës Laze.

***Luljeta Laze***: Faleminderit!

Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe të Apelit, përkatësisht me shkresat nr. 840, datë 24.08.2020 dhe nr. 278, datë 21.08.2020, kanë kërkuar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, miratimin për dhënien e shtesës së pagës për vështirësi në punë për funksionin e gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sipas nenit 12, pika 5, shkronja "d", i ndryshuar me ligjin nr. 15/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Në nenin 12, të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" është përcaktuar paga e magjistratit. Në pikën 5 të këtij neni, janë përcaktuar elementët e pagës bruto mujore të magjistratit dhe konkretisht në shkronjën d) përcaktohet: "d)shtesë për vështirësi pune, sipas parashikimeve të ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"".

Gjykatat e Posaçme të Shkallës së Parë dhe Apelit, janë ngritur me Vendimin nr. 286, datë 18.12.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucione për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Për shkak se nuk kishte një përcaktim të plotë të shkronjës d), pika 5, neni 12 i ligjit nr.96/2016, gjyqtarët e këtyre Gjykatave të Posaçme, nuk kanë mundur të marrin vështirësinë e përcaktuar në ligj.

Këshilli i Lartë Gjyqësor i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë për plotësime e përmirësime të akteve ligjore, ndërmjet të tjerave edhe për përcaktimin e vështirësisë në punë, si element i pagës së magjistratëve të institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.15/2020, datë 12.02.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016. Ky ligj është shpallur në Fletoren Zyrtare nr.140, datë 30 korrik 2020.

E drejta për përfitimin e shtesës për vështirësi në punë për magjistratët e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, ka lindur që me ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" dhe në momentin e krijimit të Gjykatave të Posaçme, të përcaktuara si institucione për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, kjo e drejtë ekzistonte.

Ligji nr.15/2020, datë 12.02.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, me ndryshimet e nenit 12, pika 5, shkronja "d", ka saktësuar masën e vështirësisë duke bërë të mundur zbatimin e drejtë të ligjit për pagën e gjyqtarëve të Gjykatave të Posaçme.

Në këtë kuptim gjyqtarët e Gjykatave të Posaçme, gëzojnë të drejtën e përfitimit të shtesës në pagë për vështirësi në punë, që nga momenti i emërimit në detyrë.

Në vlerësim të buxhetit të nevojshëm për zbatimin e nenit 12, pika 5, shkronja "d" ku përcaktohet "d) shtesë për vështirësi në punë, në masën 60 për qind të pagës bruto fillestare, për magjistratët që ushtrojnë funksionin pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar", struktura përgjegjëse e buxhetit, pranë KLGJ-së, konfirmon se Gjykata e Posaçme e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, disponon të gjithë buxhetin, në zërin "shpenzime personeli" për realizimin e pagesës së vështirësisë, që nga data e emërimit në detyrë.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nuk e disponon të gjithë fondin e nevojshëm për realizimin e pagesës së vështirësisë, por ka nevojë për një shtesë fondi prej 3,400,000 lekë.

Në analizë të realizimit të fondeve buxhetore nga gjykatat rezulton që ka fonde të lira të konfirmuara, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, 1,000,000 lekë dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 3,000,000 lekë.

Për sa më sipër sugjerojmë:

1.Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë, e cila nuk i disponon fondet për kryerjen e pagesës së vështirësisë në punë, të transferohen fondet e konfirmuara të lira të pagave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, përkatësisht 2,500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë dhe duke shtuar fondin e pagave të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, me 3,500,000 lekë.

***Naureda Llagami***: Faleminderit Luli për relatimin.

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim apo koment për projekt-aktin.

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rishpërndarjen e fondeve buxhetore të pagave “Shpenzime Personeli”, brenda programit “Buxheti Gjyqësor” të shumës prej 3,500,000 lekë, duke pakësuar fondin e pagave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, përkatësisht 2,500,000 lekë dhe 1,000,000 lekë dhe duke shtuar fondin e

“Shpenzimeve të personelit” për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit dhe Sekretari i Përgjithshëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika e 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në çështjen e radhës të rendi të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve".

Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit të projekt-aktit, z. Alban Toro.

***Alban Toro***: Projekti që është propozuar është në vazhdën e përpjekjeve që ka bërë Këshilli i Lartë Gjyqësor për të plotësuar nevojat që kanë disa institucione, ndër të tjera edhe ILD-ja me kandidatë, për të punuar pranë saj, me kandidatë nga radhët e gjyqtarëve.

Është i njëjti material që ne ju kemi sjellë shumë herë radhazi dhe që kërkojmë që kandidatë nga radhët e gjyqësorit të ofrohen për të punuar pranë ILD-së, si një nga institucionet më të rëndësishme në pushtetin gjyqësor. Kështu që në këtë kuadër, nuk dua t'ju mërzis me përmbajtjen e saj sepse relacioni është motamo me atë që ne kemi dorëzuar dhe kemi depozituar pranë jush, pra pranë Këshillit për të disatën herë dhe nën vazhdën dhe frekuencën me ILD-në për të pasur në radhët e saj gjyqtarë për të punuar për disa kohë. Kështu që ju kemi propozuar projektvendimin, i cili ka parashikuar rihapjen edhe një herë të procedurës së shpalljes së kërkesës për kandidatura, kushtet, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurat e komandimit, dhe në

fund ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nëse keni vërejtje, i gatshëm për të diskutuar. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Ftoj kolegët lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit nëse kanë ndonjë diskutim apo koment. Ndryshe kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të bërë nga relatori dhe Komisioni.

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi vendimin "Për rihapjen e procedurës së komandimit në zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve", sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika e 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 7 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

***10. Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

***11. Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

7. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Për më shumë detaje fjalën ia jap relatorit të projekt-aktit, zotit Ilir Toska.

***Ilir Toska***: Faleminderit!

Ashtu siç thatë edhe ju kryetare, zonja {...} ka kandiduar për dy pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin

nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, shpallur me vendimin e Këshillit nr. 243, datë 09.07.2020.

Nga ana e Këshillit, me vendimin nr. 268, 07.08.2020 është filluar procedura e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë, përfshirë edhe për zonjën {...}, ku relator jam caktuar unë.

Procedura e verifikimit ka filluar menjëherë. Kandidatja është njoftuar për fillimin e procedurës, për relatorin dhe nuk ka paraqitur kundërshtime. Pastaj i është kërkuar të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm në funksion të kandidimit për dy pozicionet e lira të përmendura më lart. Është paraqitur nga ana e saj ky dokumentacion. Ndërkohë, për të mundësuar vijimin paralelisht të vlerësimit etik dhe profesional të kandidates, sikurse kemi përcaktuar në pikat 9 të dy projektvendimeve me të cilat janë shpallur dy pozicionet e lira të sipërpërmendura, ka filluar verifikimi i tre kritereve formale, konkretisht të kriterit të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në kushtet e papajtueshmërisë ambientale".

Për këtë është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, po ashtu është marrë informacion edhe nga gjykatat ku zonja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec dhe nga Gjykata e Apelit Korçë.

Nga materiali i grumbulluar ka rezultuar se zonja {...} të plotësojë kriterin e "përvojës profesionale minimale" atë të përgjithshëm prej 13 vjetësh, po kështu të plotësojë edhe "përvojën profesionale minimale" sa i përket asaj specifike, pra në fushën e të drejtës civile apo të drejtës penale, pra sipas pozicioneve të lira ku ajo ka konkurruar, rezulton të ketë më tepër se 5 vjet në ushtrim të funksionit të gjyqtarit dhe të ketë përvojë në këto dy fusha të së drejtës.

Edhe sa i përket "mospasjes masë disiplinore në fuqi" është marrë informacion nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe rezulton që zonja {...} të mos ketë masë disiplinore në fuqi, gjë për të cilën ajo kishte deklaruar edhe në momentin e deklarimit.

Sa i përket kriterit të "papajtueshmërisë ambientale" zonja {...} ka plotësuar formularin tip ku deklaron se nuk do gjendet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale nëse emërohet në Gjykatën e Lartë. Ndërkohë që gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja.

Rastin ia kam përcjellë Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në datën 4 shtator 2020, konsideroi të plotë procedurën e verifikimit të tre kritereve formale të kandidimit për zonjën {...}, duke vendosur që çështja t'i kalojë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, në cilësinë e relatorit të çështjes, i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit zoti Toska për relatimin!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Më fal, mund të them diçka?

Nuk e di nëse një nga anëtarët ka papajtueshmëri në votimin e këtij projektvendimi? Meqenëse bëhet fjalë për pozicionin nr. 87. Zoti Toro ka papajtueshmëri për të marrë pjesë në votim.

***Alban Toro***: E saktë. Teorikisht unë nuk mund të marrë pjesë në votim.

Ju kërkoj ndjesë për reagimin e vonë. Ndërkohë unë kam dërguar një shkresë dorëheqjeje e cila është pranuar dhe kam listuar të gjithë gjyqtarët. Kështu që, përfitoj nga rasti që nga rendi i ditës, për pikën 11, 12, 13, 14, 16 unë të mos jem i pranishëm.

Kështu që në momentin që unë do të relatoj pikën 10, është projektvendimi në lidhje me kandidatin Sokol Binaj, kërkoj leje për të dalë nga diskutimi dhe më rithërrisni përsëri pastaj për pikën 15, për të ridalë më pas prapë dhe për të rihyrë për pikën 17 dhe 18. Faleminderit!

***Fatmira Luli***: Pro.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 87, datë 26.02.2020 dhe nr. 243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*    *    *

(Pika e 7 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 8 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

***11. Erjon Muharremaj (anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit". Lidhur me këtë projekt-akt relator është sërish zoti Toska. Fjalën për zotin Toska.

***Ilir Toska***: Faleminderit!

Zonja {...} ka kandiduar për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 09.07.2020.

Edhe në këtë rast, procedura e verifikimit ka filluar me vendimin e Këshillit nr. 268, datë 07.08.2020, ku si relator për këtë procedurë jam caktuar unë.

Zonja {...} është njoftuar për fillimin e procedurës së verifikimit dhe për relatorin. Nuk ka shfaqur pretendime as për relatorin dhe as për ndonjë nga anëtarët e Këshillit. I është kërkuar të plotësojë dokumentacionin në funksion të kandidimit të saj për në Gjykatën e Lartë. Është plotësuar ky dokumentacion dhe ndërkohë, sikurse edhe për kandidimet e tjera në Gjykatën e Lartë, për të ecur paralelisht edhe me vlerësimin etik dhe profesional të kandidatëve, paraprakisht për kandidaten janë verifikuar tre kriteret formale të kandidimit, pikërisht "përvoja profesionale minimale", "mospasja masë disiplinore në fuqi" dhe "mosqenia në kushtet e papajtueshmërisë ambientale në rast të emërimit në Gjykatën e Lartë".

Informacioni është marrë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor po kështu edhe nga gjykatat ku zonja {...} ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, konkretisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe prej datës 19.12.2019 Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Të dhënat e ardhura janë reflektuar të gjitha në relacionin shpjegues që iu është shpërndarë paraprakisht të gjithë anëtarëve.

Po kështu kandidatja ka plotësuar edhe formularët tip që kërkohet në funksion të kandidimit të saj për në Gjykatën e Lartë. Nga të dhënat e grumbulluara, rezulton që zonja {...} të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë, po kështu të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale, siç kërkohet për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Po kështu rezulton që zonja {...} të mos ketë masë disiplinore në fuqi, sikundër nga ana e saj është deklaruar që nuk do të gjendet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale në rast se emërohet në Gjykatën e Lartë dhe gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga kjo e deklaruar prej kandidates.

Rastin ia kam referuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 4 shtator 2020 konsideroi procedurën e verifikimit të tre kritereve formale të kandidimit të zonjës {...} si të plotë, duke vendosur që çështja t'i kalojë për shqyrtim Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...}, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 241,

datë 09.07.2020, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 241, datë 09.07.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toska!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj.{...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*          *          *

(Pika e 8 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 9 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 242, nr. 243 dhe nr. 244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

***10. Marçela Shehu (anëtare)***

***11. Erjon Muharremaj (anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

9. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në çështjen e radhës, e cila edhe kjo ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore për kandidatin {...}, lidhur me procedurën e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje, fjalën ia jap relatorit të projekt-aktit z. Alban Toro.

***Alban Toro:*** Zoti {...} aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është njëri nga kandidatët të cilët kanë konkurruar për në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për tre pozicione në fushën e të drejtës penale që janë shpallur me vendimet 242, 243 dhe 244.

Në kuadër të kryerjes së detyrës së relatorit, i caktuar si i tillë me vendimin nr. 268, 07.08.2020 nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, kam kërkuar dhe administruar dokumentacionin e

nevojshëm i cili provon plotësimin e tre kritereve formale të kërkuara nga nenet 47/4, 48/8 dhe 8/3 të Ligjit për Statusin.

Aktualisht këto akte ju janë shpërndarë dhe janë pasqyruar të detajuara në relacion, kështu që nuk po ju humbas kohë duke jua cituar.

Nga vlerësimi i tyre ka rezultuar që kandidati rezulton të ketë mbi 13 vjet pune përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në shkallën e parë, mbi 5 vjet pune përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale dhe gjithashtu nuk rezulton të ketë ndonjë masë disiplinore në fuqi apo në rastin hipotetik të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë të bie ndesh me papajtueshmërinë ambientale, të përcaktuar nga neni 8/3 i Ligjit për Statusin.

Kështu që, në këto kushte, pasi kam marrë edhe miratimin e Komisionit për zhvillimin e procedurës është përgatitur drafti i projektvendimit, në dispozitiv të të cilit ju propozohet: 1.

Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, kalojmë në diskutimin e projekt-aktit. Nëse s'kemi diskutime, kalojmë në miratimin e tij?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.242, nr.243 dhe nr.244, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit".

*   *   *

(Pika e 9 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 10 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandididimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020, të këshillit të lartë gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

***10. Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

***11. Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

10. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020, të këshillit të lartë gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë edhe kjo me verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore për kandidatin z. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish zotit Alban Toro.

***Alban Toro***: Edhe zoti {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është një nga kandidatët i cili konkurron në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë në tre fusha të së drejtës penale të shpallura më parë me vendimin nr. 241, 242, 243, 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me cilësinë e relatorit kam kërkuar dhe kam administruar dokumentacionin i cili provon plotësimin e kritereve formale nga ana e tij në lidhje me procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, parashikuar nga nenet 47/4, 48/8 dhe 8/3 të Ligjit për Statusin.

Të dhënat e këtyre akteve janë pasqyruar gjerësisht në relacion, të cilët ju e dispononi. Po ju jap në mënyrë të sintetizuar që kandidati rezulton të ketë mbi 15 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë dhe gjyqtar në gjykatën e shkallës së dytë. Gjithashtu ka mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale. Nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi dhe në rastin hipotetik të emërimit të tij në Gjykatën e Lartë nuk vërtetohet që të jetë në një situatë papajtueshmërie ambientale në të.

Kështu që, pasi kam marrë miratimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ju kemi kaluar për miratim projektvendimin, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni: 1.

Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toro!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime lidhur me projekt-aktin, kalojmë në miratimin e tij?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", sipas propozimit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika e 10 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 11 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

***10. Erjon Muharremaj (anëtar)***

***Shënim***: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Alban Toro.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

11. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në çështjen e radhës e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit për kandidaten znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

***Alban Toro***: Kërkoj ndjesë.

***Naureda Llagami***: Alban, mund të dalësh nga linja. Faleminderit!

***Alban Toro***: Po! Atë do thoja.

***Naureda Llagami***: Atëherë, për më shumë detaje ia jap fjalën relatores së projekt-aktit, zonjës Marçela Shehu.

***Marçela Shehu***: Faleminderit, Kryetare!

Kandidatja znj. {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë për dy pozicione në fushën e së drejtës administrative, konkretisht për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 84, 26.02.2020 dhe për pozicionin e shpallur me vendim të Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020.

Ka filluar procedura e verifikimit për këtë kandidate, për tre kriteret formale. Rezulton se zonja {...} përmbush kriterin e "përvojës së përgjithshme profesionale" në respektim të kërkesave ligjore, pasi rezulton të ketë mbi 13 vjet si gjyqtare e shkallës së parë. Rezulton të plotësojë edhe kriterin tjetër atë të "përvojës minimale profesionale specifike", pasi rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës administrative; si dhe plotëson edhe dy kushtet e tjera, atë të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "papajtueshmërisë ambientale", pasi nga verifikimi ka rezultuar se nuk konstatohen probleme me këtë kriter.

Në këto kushte, në cilësinë e relatores, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor: Verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të këtyre kritereve që citova, dhe vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet që ajo ka kandiduar. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zonja Shehu për relatimin!

Atëherë, lidhur me projekt-aktin nëse keni diskutime? Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*  *  *

(Pika e 11 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 12 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 e nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

*9. Marçela Shehu* *(anëtare)*

*10. Erjon Muharremaj* *(anëtar)*

***Shënim***: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Alban {...}.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

12. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 e nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në pikën e radhës së rendit të ditës e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 e nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë

Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Për më shumë detaje të projekt-aktit fjalën ia jap relatores znj. Marçela Shehu.

***Marçela Shehu***: Kandidatja zonja {...} ka kandiduar, sikurse edhe ju e cituat, në fushën e së drejtës civile për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, po në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin e shpallur me vendim të Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020.

Me cilësinë e relatores, kam realizuar procesin e verifikimit të përmbushjes nga kjo kandidate të kritereve minimale që kërkohen për fillimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë.

Në mënyrë të detajuar, të gjitha verifikimet janë parashtruar në relacionin që tashmë e keni në dispozicion. Gjatë procedurës së verifikimit ka rezultuar se zonja {...} përmbush kriterin e "përvojës së përgjithshme profesionale", pasi rezulton të ketë mbi 13 vjet përvojë profesionale si gjyqtare e shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë specifike profesionale në fushën e së drejtës civile dhe në atë administrative. Rezulton të mos ketë masë disiplinore në fuqi dhe rezulton të mos ketë probleme lidhur me kriterin e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të kritereve të sipërcituara dhe vijimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zonja Shehu për relatimin e projekt-aktit!

Nëse kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin, ndryshe kalojmë në votimin e tij?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 e nr. 245, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*　　*　　*

(Pika e 12 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 13 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

***Shënim***: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Alban Toro.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

13. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kushteve për kandidaten znj. {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile nr. 87 dhe në fushën e të drejtës penale nr. 243, datë 09.07.2020. Për më shumë detaje fjalën e ka relatorja znj. Marçela Shehu.

***Marçela Shehu***: Kandidatja zonja {...} ka kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, shpallur me

vendimin e Këshillit nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, shpallur me vendimin e Këshillit nr. 243, datë 09.07.2020.

Me cilësinë e relatores kam realizuar procedurën e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit të kësaj kandidateje. Ka rezultuar nga procesi i verifikimit se zonja {...} i plotëson të gjitha këto kritere. Ajo rezulton të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë; rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike si në fushën e së drejtës civile ashtu edhe në fushën e së drejtës penale. Nuk rezulton të ketë masë disiplinore në fuqi dhe nuk rezulton ndonjë problem lidhur me kriterin e papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, pas miratimit dhe të procedurës së kryer edhe nga Komisioni, me cilësinë e relatores i propozoj KLGJ-së verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të tre kritereve ligjore dhe vijimin e procedurës së verifikimit të mëtejshëm. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Atëherë, kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim të projekt-aktit sipas propozimit?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projekt-aktit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor...”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*          *          *

(Pika e 13 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***<u>Pika 14 e rendit të ditës me objekt</u>:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit" i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

***Shënim***: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Alban Toro.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

14. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit" i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në projekt-aktin e radhës i cili ka të bëjë me verifikimin e plotësimit të kritereve ligjore për kandidaten znj. {...} për tre kriteret e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Për më shumë detaje fjalën ia jap sërish relatores së projekt-aktit znj. Marçela Shehu.

***Marçela Shehu***: Faleminderit, Kryetare!

Kandidatja, gjyqtarja {...} ka kandiduar për pozicionin e lirë për fushën e së drejtës civile në Gjykatën e Lartë, pozicion ky i shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me cilësinë e relatores, kam realizuar procedurën e verifikimit të kritereve formale ligjore. Në mënyrë të detajuar, gjithçka është detajuar në relacionin përkatës që ju e dispononi. Pas procedurës së këtij verifikimi paraprak ka rezultuar se zonja {...} i plotëson të gjitha kriteret për kandidimin e saj në Gjykatën e Lartë, pra kriteret minimale ligjore. Rezulton të ketë mbi 13 vjet gjyqtare në shkallën e parë; rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale specifike në fushën e së drejtës civile; nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi dhe nuk rezulton të ketë probleme të evidentuara me papajtueshmërinë ambientale.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores, pas miratimit edhe të procedurës nga ana e Komisionit, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor, verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të kritereve të "përvojës profesionale minimale" të "mospasjes së masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale" dhe për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zonja Shehu!

Atëherë, nëse nuk kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin, kalojmë në votimin e tij?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*          *          *

(Pika e 14 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 15 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

***10. Marçela Shehu*** ***(anëtare)***

***11. Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4.Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.***

***5. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***6. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***7. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***8. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

15. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

***Naureda Llagami***: Përpara se të kalojmë në shqyrtimin e projekt-aktit të radhës, duhet të ftojmë zotin Alban Toro të jetë "online". Të lutem stafit, mund ta mundësojë?

***Alban Toro***: Jam prezent.

***Naureda Llagami***: Atëherë, kalojmë tek shqyrtimi i çështjes së radhës e cila ka të bëjë me verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor..." dhe për më shumë detaje ia jap fjalën sërish relatores znj. Marçela Shehu.

***Marçela Shehu:*** Kandidatja zonja {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin nr. 241, nr. 242 dhe nr. 243, datë 09.07.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me cilësinë e relatores kam realizuar procesin e verifikimit të kritereve formale lidhur me kandidimin e saj për në Gjykatën e Lartë dhe nga procedura e verifikimit ka rezultuar se zonja {...} përmbush kriteret ligjore për kandidimin e saj në Gjykatën e Lartë. Rezulton që kjo kandidate të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale në gjykatat më të ulëta; rezulton të ketë mbi 5 vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës penale; nuk rezulton të ketë masa disiplinore në fuqi dhe nuk evidentohen rrethana të cilat mund të vënë në diskutim përmbushjen nga ana e saj të kriterit të papajtueshmërisë ambientale.

Në këto kushte, me cilësinë e relatores, i propozoj Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikimin e plotësimit nga kjo kandidate të këtyre kritereve dhe vijimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit të kandidates për kriteret e tjera ligjore. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, Marçela!

Atëherë, kalojmë në diskutimin e projekt-aktit. Nëse jo, kalojmë në votimin e tij?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Pro.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për tre pozicione të lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr.241, nr.242 dhe nr.243, datë 09.07.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për

kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*          *          *

(Pika e 15 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 16 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore z. Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***

9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
10. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

***Shënim***: Nuk mori pjesë në këtë pikë të rendit të ditës anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Alban Toro.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

16. Shqyrtimi i projektvendimit "Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore z. Ilir Toska).

***Naureda Llagami***: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për dy pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë.

Për më shumë detaje, fjalën ia jap z. Ilir Toska, relator i projekt-aktit.

***Ilir Toska***: U largua zoti Toro.

Zoti {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, konkretisht për pozicionin në fushën e së drejtës administrative të shpallur me vendimin nr. 84, datë 26.02.2020. Për pozicionin e lirë, në të njëjtën fushë, pra në të drejtën administrative, të shpallur me vendimin nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020.

Edhe në këtë rast, procedura e verifikimit ka filluar me të njëjtin vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pra me vendimin nr. 268, datë 07.08.2020, z. {...} është njoftuar për fillimin e kësaj procedure dhe për relatorin përkatës që jam caktuar unë. Nuk ka pasur pretendime as për relatorin dhe as për ndonjë nga anëtarët e Këshillit. Zoti {...} është njoftuar për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm të kandidimit, i cili është plotësuar brenda afateve të caktuara.

Ndërkohë ka vijuar procesi sa i përket verifikimit paraprak të tre kritereve formale, me qëllim hapjen rrugë të fillimit të procesit të vlerësimit etik dhe profesional, sikurse është përcaktuar në pikën 9 të vendimeve të Këshillit me të cilat janë shpallur të lira tre pozicionet ku ai kandidon.

Nga verifikimi i tre kritereve formale, pra “përvojës profesionale minimale”, “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, janë marrë të dhëna nga vetë kandidati, nga gjykatat ku ai ka punuar, konkretisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Apelit Tiranë, po kështu janë marrë të dhëna edhe nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga të dhënat që janë evidentuar hollësisht nga relacioni që është shpërndarë, rezulton që zoti {...} të ketë mbi 13 vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtar në gjykatën e shkallës së parë dhe në shkallën e dytë, nga të cilat, mbi 5 vjet përvojë në fushën e të drejtës civile dhe në fushën e të drejtës administrative. Pra respektivisht, sipas fushave të nevojshme për të cilat janë shpallur pozicionet e lira.

Ndërkohë, sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore, përveç deklarimit të kandidatit, është marrë edhe konfirmimi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit dhe rezulton se nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Sa i përket kriterit të “papajtueshmërisë ambientale”, është marrë deklarimi nga vetë kandidati, që deklaron që nuk do ndodhet në kushtet e papajtueshmërisë ambientale në rast emërimi në Gjykatën e Lartë, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk na rezulton ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidati.

Rastin ia kam referuar Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, i cili në mbledhjen e datës 15.09.2020 ka konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të ndjekur për sa i përket 3 kritereve formale të kandidimit, duke vendosur që çështja t'i kalojë Këshillit të Lartë Gjyqësor për shqyrtim.

Në cilësinë e relatorit, i propozoj Këshillit që të vendosë: Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020, të kritereve të "përvojës profesionale minimale", të "mospasjes masë disiplinore në fuqi" dhe të "mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale".

Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020.

Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z.{...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kalojmë në diskutim dhe më tej në votimin e projekt-aktit sipas propozimit. Hyjmë në votim?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit: Për verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...} të tre kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020 dhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*        *        *

(Pika 16 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot.                                                  Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 17 e rendit të ditës me objekt***: Shqyrtimi i projektvendimit "Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Ilir Toska).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

17. Shqyrtimi i projektvendimit "Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z.Ilir Toska).

***Naureda Llagami***: Atëherë, kalojmë në projekt-aktin e radhës.

Përpara se të kalojmë, duhet të ftojmë Albanin të jetë "online".

Klodi, mundëso Albanin të jetë "online".

***Alban Toro***: Jam prezent.

A dëgjohem?

***Naureda Llagami***: Po, Alban!

Atëherë, fillojmë me çështjen tjetër, me projektvendimin i cili ka të bëjë me zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}. Edhe ky projekt-akt është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës. Do të relatohet nga zoti Toska.

***Ilir Toska***: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin "Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të

magjistrates znj. {...}”. Krahas projektvendimit ju është përcjellë edhe relacioni lidhur me këtë projektvendim.

Shkurtimisht mund t’ju them se mbas krijimit, më datë 01.02.2020, të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zgjedhjen e z. Artur Metani si Inspektor të Lartë të Drejtësisë përmes Vendimit nr.2/2020, datë 20.01.2020, të Kuvendit të Republikës, mbi njoftimin dhe kërkesën e tij, me shkresën nr. 14 prot., datë 03.02.2020, mbështetur në nenin 283, pika 10, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qe qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, sikundër edhe në nenin 168, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 69, datë 07.02.2020, vendosi: “1. Komandimin e përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}, për një periudhë 6-mujore. 2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data e njoftimit.”

Efektet juridike të vendimit si më lart të Këshillit kanë filluar më datë 13.02.2020.

Më datë 13.07.2020, magjistratja e komanduar znj. {...} ka vënë në dijeni Këshillin e Lartë Gjyqësor për përfundimin e periudhës së komandimit të përkohshëm si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, më datë 13.08.2020.

Me shkresën nr. 5/5 prot., datë 09.09.2020, protokolluar me aktin nr. 4211, datë 10.09.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kërkuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektore në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj.{...}.

Në kërkesën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë parashtron:

“... gjatë periudhës së komandimit, magjistratja ka kandiduar për ngritje në detyrë në gjykatë apeli të juridiksionit të përgjithshëm, referuar pozicioneve të lira të shpallura nga Këshilli në muajin maj, ndërsa në fund të muajit korrik, ka vënë në dijeni Këshillin për përfundimin e afatit të saj të komandimit pranë Zyrës së ILD-së, në datë 13 gusht 2020.

Ndërkohë, sikundër ju jeni në dijeni përveç magjistrates {...} të komanduar nga ana juaj pranë Zyrës së ILD-së, ende nuk është rekrutuar asnjë inspektor magjistrat apo jomagjistrat, ndërsa organika e miratuar për këtë kategori punonjësish është 28, nga të cilët 14 inspektorë magjistratë duhet të komandohen nga këshillat përkatës KLGJ dhe KLP, ndërsa 14 inspektorë jomagjistratë rekrutohen nga ILD.

Nga Zyra e ILD-së, vijon procedura për rekrutimin e inspektorëve jomagjistratë, procedurë e cila ndodhet në fazën e verifikimit të figurës dhe të pasurisë së kandidatëve për inspektor jomagjistrat nga ana e organeve ndihmëse të këtij procesi.

Aktualisht Zyra e ILD-së, ndodhet në vështirësi praktike pasi ende nuk ka asnjë inspektor tjetër të emëruar në detyrë pranë kësaj Zyre, situatë e cila rrezikon të sjellë pezullim të procedurave administrative në trajtimin e praktikave në proces pune pranë inspektore {...} dhe për rrjedhojë të funksionit bazë që ka Inspektori i Lartë i Drejtësisë, atë të shqyrtimit të ankesave nga gjyqtarëve dhe prokurorëve, referuar nenit 147/d të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit 194 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Për këtë shkak, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së procesit administrativ të trajtimit të praktikave në respektim të afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke mos sjellë nga njëra anë vonesa të tjera, për këtë shkak, në trajtimin e ankesave të qytetarëve dhe nga ana tjetër, të garantimit të një procesi të rregullt ligjor për magjistratin ndaj të cilit paraqiten ankesa, si dhe duke patur në konsideratë përvojën profesionale të magjistrates me vlerë për institucionin, në cilësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, propozoj zgjatjen e afatit të komandimit të magjistrates {...} nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga 13 gusht 2020 deri në përfundimin e procedurave të iniciuara nga Këshilli për ngritje në detyrë të magjistratëve për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura në muajin maj, pozicione për të cilat ka kandiduar edhe inspektore {...}. ...".

Ndërkohë, me shkresën nr.5/6 prot., datë 09.09.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.4212, datë 10.09.2020, magjistratja e komanduar znj.{...}, mbasi është njohur me kërkesën si më lart të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor duke i parashtruar: "Dhënien e pëlqimit për zgjatjen e afatit të komandimit të saj pranë Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, deri në përfundimin e procedurave të iniciuara nga Këshilli për ngritjen në detyrë të magjistratëve për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura nga Këshilli në muajin maj, pozicione për të cilat ka kandiduar".

Rezulton se magjistratja e komanduar znj. {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës civile dhe për një

pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallura me Vendimet nr. 182, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor".

Procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për tre pozicionet e lira si më lart ku ka kandiduar edhe magjistratja e komanduar znj. {...}, rezultojnë të jenë në proces e sipër, ndërsa Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimet e datave 8 dhe 10 shtator 2020, ka verifikuar plotësimin nga kandidatët të tre kritereve formale të kandidimit për këto pozicione, përfshirë edhe për znj. {...}, sipas Vendimit nr. 309, datë 10.09.2020. Procedurat e ngritjes në detyrë për këto pozicione të lira vijojnë në lidhje me verifikimin e kandidatëve për kriteret e tjera ligjore të kandidimit, konkretisht pasurisë dhe figurës, krahas vlerësimit të tyre etik dhe profesional, për t'u përmbyllur me renditjen e tyre dhe përzgjedhjen e kandidatit të renditur me lart, i cili në finale do të ngrihet në detyrë për pozicionin e lirë respektiv.

Në situatën si më lart, kur inspektor i vetëm në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është magjistratja e komanduar znj. {...}, në kushtet kur pavarësisht hapjes disa herë të procedurave të komandimit të gjyqtarëve si inspektor pranë këtij institucioni të sistemit të drejtësisë nuk është paraqitur asnjë kandidaturë, ndërkohë që është paraqitur sërish kërkesë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për hapjen e procedurave të komandimit për gjashtë pozicione të lira, për të cilat ne pak më herët morëm vendimin për rihapjen e këtyre procedurave, nisur nga interesi i lart publik për funksionimin e këtij institucioni, me rëndësi për mirëfunksionimin edhe të sistemit gjyqësor, përgjegjës për mbarëvajtjen e të cilit është Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërsa nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është kërkuar zgjatja e afatit të komandimit për magjistraten znj. {...} për një periudhë të kufizuar kohore, brenda të cilës është e pritshme rekrutimi i inspektorëve jomagjistratë apo edhe i inspektorëve magjistratë prokurorë, zgjatja e afatit të komandimit për të cilën ka dhënë pëlqimin edhe magjistratja, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin e paraqitur për shqyrtim, pra "Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}".

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në katër pika.

Pika 1 e projektvendimit bën fjalë pikërisht për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...},

duke përcaktuar si afat deri në përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë ku ajo ka kandiduar.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohen momenti i fillimit të efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data 13.08.2020, duke mbajtur parasysh se në këtë datë ka përfunduar komandimi i përkohshëm sipas vendimit të mëparshëm të Këshillit, pikërisht Vendimi nr. 69, datë 07.02.2020, ndërkohë që një gjë e tillë nuk pengohet nga ligji, sa kohë magjistratja nuk është caktuar në një pozicion tjetër, përveç se kjo është kërkesë, por edhe në favor, të të dy palëve të interesuara në këtë procedurë.

Më tej, në pikën 3 të projektvendimit, përcaktohet detyrimi i Këshillit për njoftimin e vendimit magjistrates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet e drejta e ankimit ndaj vendimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet edhe publikimi i vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e projekt-aktit? Nëse jo, kalojmë në votim?

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit “Për zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

*         *         *

(Pika 17 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Pika 18 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë", i përgatitur nga relator z. Dritan Hallunaj.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

**RENDI I DITËS:**

18. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë", i përgatitur nga relator z. Dritan Hallunaj.

***Naureda Llagami***: Kalojmë në çështjen e fundit besoj të rendit të ditës. Është shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë", i përgatitur nga z. Dritan Hallunaj. Fjala për ty Dritan!

***Dritan Hallunaj***: Faleminderit, Kryetare!

Po parashtroj relacionin "Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kritereve për caktimin dhe zgjatjen e afatit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë".

Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datë 03.08.2020 është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, dhe nenit 138 të ligjit nr.96/2016

"Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja "a" e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 2, shkronjat "a" dhe "b", te ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Së bashku me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistratit {...}, të masës disiplinore "Shkarkim nga detyra", të parashikuar nga neni 111 i ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Bashkëlidhur kërkesës është depozituar raporti i hetimit disiplinor si dhe dosja hetimore.

Me vendimin nr. 273, datë 26.08.2020 të Këshillit është vendosur hedhja e shortit dhe caktimi i relatorit dhe në rastin konkret jam caktuar unë si relator i këtij çështjeje.

Ky vendim mbi caktimin me short të relatorit të çështjes i është njoftuar palëve të procedimit disiplinor përkatësisht ILD-së dhe magjistratit {...}, në datë 31.08.2020, brenda afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 141 të Ligjit 96/2016.

Rezultatet e verifikimit paraprak të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor.

Pas paraqitjes në Këshill të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, menjëherë u procedua me verifikimin nëse kërkesa plotëson kriteret formale te parashikuara në ligj.

Rezulton se sipas shkresës nr.313/43 prot., datë 30.07.2020 të ILD-së, kërkesa është paraqitur nga vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë së bashku me raportin e hetimit dhe dosjen përkatëse me të gjithë elementët e parashikuar në nenin 133 të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe për rrjedhojë i plotëson kriteret formale të kërkuara.

Pas verifikimit të plotësimit të kritereve formale të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit {...}, u verifikuan edhe kushtet e parashikuara në nenin 139 të ligjit nr. 96/2016, mbi mbylljen e procedimit disiplinor pa seancë dëgjimore.

...Këshilli vendos mbylljen e procedimit disiplinor pa zhvilluar seancë dëgjimore nëse: a) shkelja disiplinore është parashkruar në kohën kur ka filluar hetimi, sipas parashikimeve të nenit 117 të këtij ligji; b) çështja ka qenë objekt i procedimit disiplinor që është zgjidhur me vendim të formës së prerë; c) ka arsye të tjera për të mbyllur procedimin, në përputhje me parashikimet e nenit 134, pika 1, shkronjat 'ç' dhe 'd'; ç) raporti i hetimit është depozituar pa u arsyetuar.

Rezulton se nuk gjendemi para ndonjë kushti të parashikuar si më sipër pasi:

a) nuk ka kaluar afati 5-vjeçar i parashkrimit të shkeljes disiplinore të pretenduar pasi vendimi gjyqësor dhe shkelja e pretenduar është e datës 14.02.2019;

b) nga verifikimet e kryera rezulton se çështja nuk ka qenë objekt i ndonjë procedimi disiplinor të zgjidhur me vendim të formës së prerë, pasi menjëherë pas dhënies së vendimit gjyqësor nr. 41-2019, datë 14.02.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Ministria e Drejtësisë ka paraqitur ankesë zyrtare me shkresën nr. 1685 prot., datë 20.02.2019 pranë KLGJ, i cili e ka përcjellë për kompetencë trajtimi pranë zyrës së ILD-së, me shkresën nr. 258/1 prot., datë 19.02.2020.

c) nuk jemi para ndonjë prej kushteve të parashikuara nga shkronjat ‘ç’ dhe ‘d’, të pikës 1, të nenit 134 të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përkatësisht mbarimit të statusit të magjistratit ose pamundësisë mendore dhe fizike si dhe vdekja.

ç) raporti i hetimit i bashkëlidhur me kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor nga ILD është i arsyetuar.

Në këto kushte Këshilli duhet të caktojë datën për seancën dëgjimore, e cila duhet të jetë brenda 1 muaji nga dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në caktimin e datës së seancës dëgjimore Këshilli duhet të mbajë në konsideratë edhe afatin 15-ditor të njoftimit të palëve për datën e seancës dëgjimore sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Duke qenë se dosja e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është protokolluar pranë Këshillit në datën 03.08.2020, gjatë periudhës së lejes vjetore, është e nevojshme zgjatja e afatit të seancës dëgjimore deri në dy muaj, kjo sipas parashikimeve të nenit 138 të Ligjit nr. 96/216 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Duke vlerësuar të plotë procedurën e verifikimit paraprak të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor, relatori i çështjes ia parashtroi rastin Komisionit të Disiplinës.

Në mbledhjen e datës 16.09.2020 Komisioni i Disiplinës duke konsideruar se verifikimet paraprake të kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor janë të plota, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për caktimin e seancës dëgjimore bazuar në nenin 138, pika 2, germa ‘a’, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të

vendos mbi zgjatjen e afatit për caktimin e seancës dëgjimore bazuar në pikën 3 të nenit 138 të këtij ligji.

Bashkëlidhur është edhe projektvendimi që ne si Komision i Disiplinës po parashtrojmë në seancë plenare, përfundimisht duke vendosur:

1. Zgjatjen e afatit të datës së seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkak të periudhës së pushimeve vjetore.

2. Caktimin e datës 02.10.2020, si datën e zhvillimit të seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet palëve në procedurën disiplinore Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 138 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky ishte relatimi.

***Naureda Llagami***: Faleminderit, zoti Hallunaj për relatimin e projekt-aktit!

Nëse nuk kemi ndonjë diskutim nga ana e kolegëve, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

***Erjon Muharremaj***: Mundem zonja Kryetare?

***Naureda Llagami***: Po, Erjon!

***Erjon Muharremaj***: Vetëm një propozim për një ndërhyrje të vogël në pikën 1 kisha, për sa i përket formulimit, që të thuhet jo "Zgjatjen e afatit të datës" por "Zgjatjen e afatit dhe caktimin e datës". Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Atëherë, hartuesit e projekt-aktit jeni dakord me propozimin?

***Dritan Hallunaj***: Ne i kemi qëndruar strikt asaj çfarë thotë ligji dhe konkretisht neni 138 që është pika 3 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" dhe aty shprehimisht shprehet "të zgjasë afatin e parashikuar" dhe kemi përdorur këtë shprehje "zgjatjen e afatit të datës së seancës gjyqësore". Megjithatë, si ta vlerësojë Këshilli. Nuk ka asnjë problem.

***Naureda Llagami***: Duke qenë se është një gabim, le të themi lapsus, jemi dakord nga ana e kolegëve?

***Brunilda Kadi***: Për cilën pjesë sepse ka dy të ndryshme dhe të dimë për çfarë po votojmë.

***Dritan Hallunaj***: Atë që thashë. Atë lexova unë.

Tek pjesa vendosi "Zgjatjen e afatit të datës së seancës dëgjimore". Ndërsa Erjoni thotë "Zgjatjen e afatit dhe shtyrjen e seancës dëgjimore...", pra thjesht ka të bëjë me shprehinë e përdorur.

Unë jam dakord si të vlerësohet nga ana e anëtarëve.

***Marçela Shehu***: Mendoj që ai propozimi i Erjonit qëndron. Duket pak i qartë dhe nënkupton më shumë atë çka është dashur të thuhet. Kështu që unë jam dakord me propozimin e Erjonit.

***Brikena Ukperaj***: Erjon, propozimi ishte që tek pika 1 të ishte "Zgjatja e afatit...

***Naureda Llagami***: ... dhe caktimi i seancës dëgjimore.

***Erjon Muharremaj***: Nga pikëpamja gjuhësore, formulimi "Zgjatja e afatit të datës" nuk më duket korrekte, prandaj e bëra propozimin që të korrigjohet.

***Brikena Ukperaj***: Konkretisht si ishte formulimi "Zgjatja e afatit...?

***Dritan Hallunaj***: ... dhe caktimi i seancës dëgjimore".

***Brikena Ukperaj***: Tek pika 1 dhe pika 2 e projektvendimit parashikohen dy gjëra të ndryshme. Pika e parë ka të bëjë me marrjen e vendimit që ne do ta zgjasim afatin. Tek pika e dytë ka të bëjë me datën e caktimit. Kështu që, tek pika e parë unë mendoj që ndoshta nga ana gjuhësore do të ishte më e mirë "Zgjatja e afatit të zhvillimit të seancës dëgjimore" dhe jo "Zgjatja e afatit dhe caktimi i seancës dëgjimore". Pra ne në pikën e parë zgjasim afatin se kur do ta zhvillojmë seancën gjyqësore dhe pika e dytë të lihet siç është.

***Ilir Toska***: Mund të them diçka?

***Naureda Llagami***: Po, Ilir!

***Ilir Toska***: Sikundër sugjeron edhe zonja Ukperaj, është më e qartë nëse ne do të shprehemi "Zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës". Ligji na ka përcaktuar një afat brenda të cilit ne duhet ta shqyrtojmë kërkesën, duke lënë edhe një hapësirë dhe ne pikërisht po

shfrytëzojmë hapësirën që na jep ligji, referuar situatës që muaji gusht ishte me leje dhe në këtë pikëpamje duhet të shprehemi që po zgjasim afatin e shqyrtimit të kërkesës së ILD-së, pra duhet të hiqet "data e seancës dëgjimore" dhe të kalohet direkt "zgjatjen e afatit për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së". Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Atëherë, u bënë tre propozime.

Propozimi i Erjonit ishte "Zgjatja e afatit dhe caktimi i datës së seancës dëgjimore"; propozimi i Brikenës ishte "Zgjatja e afatit të zhvillimit të seancës dëgjimore"; dhe propozimi i Ilirit ishte "Zgjatja e afatit për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së".

***Erjon Muharremaj***: Propozimi i zotit Toska është më konciz, kështu që unë e tërheq propozimin tim. Vetëm thjesht formulimi "Zgjatja e afatit të datës" nuk më shkonte, prandaj edhe e bëra propozimin. Faleminderit!

***Marçela Shehu***: Edhe unë jam dakord. Ideja ishte që të dilte sa më e qartë dhe mos të kishte konfuzion.

***Brikena Ukperaj***: Dakord jam edhe unë me propozimin e zotit Toska.

***Naureda Llagami***: Atëherë, relatori, jeni dakord?

***Dritan Hallunaj***: Po, dakord!

Plotësisht, dakord! "Zgjatjen e afatit të shqyrtimit të kërkesës së ILD-së" - është formulimi më korrekt.

***Naureda Llagami***: Atëherë, le ta mendojmë që është një riformulim ky dhe e hedhim aktin sipas propozimit që u pranua, le të themi, nga të gjithë, për "zgjatjen e afatit për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së". Hedhim në votim projekt-aktin me këtë ndryshim.

***Maksim Qoku***: Dakord.

***Brunilda Kadi***: Dakord.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ilir Toska***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Erjon Muharremaj***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Medi Bici***: Pro.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi projekt-aktin “Për caktimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë”, sipas propozimit të bërë nga relatori dhe sugjerimeve të dhëna nga kolegët për formulimin e këtij projekt-akti.

*  *  *

(Pika 18 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2020

***PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 17.09.2020)***

***Diskutim jashtë rendit të ditës mbi vijimin e disa seancave të mbledhjeve plenare në një ambient të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 13:48.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Maksim Qoku*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Medi Bici*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Brunilda Kadi*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ilir Toska*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtar)***
10. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
11. ***Erjon Muharremaj*** ***(anëtar)***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.***

***5. Pjesë nga stafi administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***6. Entela Dobi, përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.***

***7. Përfaqësues të Misionit EURALIUS dhe Projektit të "USAID".***

***Naureda Llagami***: Atëherë, përpara se ta mbyllim mbledhjen e sotshme, kam edhe një çështje tjetër informuese për Këshillin, e cila ka të bëjë me zhvillimin e seancave lidhur me kandidatin e katërt dhe kandidatët që kemi për në Gjykatën e Lartë si edhe me magjistratët që kanë mbaruar shkollën dhe që presin të verifikohen.

Siç jeni në dijeni unë ju kam informuar edhe herë tjetër për sa i përket mundësive për të zhvilluar seancat për këto kandidatë për të cilat bashkë e dimë shumë mirë që kërkohet shqyrtimi i relacioneve që përmbajnë edhe informacione të klasifikuara, duke qenë se nga ana e autoriteteve përkatëse na është udhëzuar që nuk mund t'i zhvillojmë seancat në platforma "online" për çështje të tilla.

Me kalimin në godinën e re, duke qenë se godina e vjetër nuk na e mundësonte ambientin/hapësirën e nevojshme për zhvillimin e këtyre seancave dhe për të ruajtur distancat e protokollit të pandemisë, nga ana e stafit administrativ të Këshillit janë marrë masat për një ambient (jo ambienti i mbledhjeve plenare por një ambient tjetër edhe më i madh), i cili është i madh, ka ventilim, ka dritare dhe nga ana e stafit është dezinfektuar dhe janë marrë të gjitha masat e një zone sigurie që kërkohet në zbatim të ligjit, për të diskutuar këto lloj çështjesh dhe problematikash që neve kemi në punën tonë. I vetmi problem që neve kemi në diskutimin e këtyre çështjeve në këtë ambient ku mund të ruajmë lehtësisht distancën dhe të gjitha kushtet e protokollit të pandemisë është fakti që ne jemi në kushte pamundësie për të bërë regjistrimin audio, duke qenë që procedurat e regjistrimit audio, prokurimi në ambientet e reja, për shkak të pandemisë, pavarësisht se nga stafi janë marrë masat që të kryheshin që në fillim të vitit, për shkak të pandemisë u pezulluan.

Marrë në konsideratë edhe sensibilitetin e çështjeve që shfaqin, jo vetëm për Këshillin por edhe për përfundimin e këtyre procedurave, unë në fakt do e ngre për diskutim dhe kërkoj vlerësim nga ana juaj nëse i kemi ambientet dhe a mundet që për këtë lloj çështjeje ne të futemi për vendimmarrje, në mungesë të audios, por duke e zëvendësuar që procesverbalin ta mbajmë me shënim nga stafi përkatës.

***Ilir Toska***: Me leje?

Atëherë, unë mendoj që do duhet të procedojmë sepse afatet ecin dhe ne jemi të përgjegjshëm që duhet t'i përfundojmë ato procedura, pasi bëhen pengesë qoftë për krijimin e Gjykatës së Lartë (për vënien në funksionim të Gjykatës së Lartë), qoftë për fillimin e Shkollës së Magjistraturës, qoftë për ngritjen në detyrë për gjyqtarët e gjykatave të apeleve sepse ato janë rresht tani të gjitha këto procedura dhe do duhet të operojmë. Fakti që ne sot jemi në pamundësi objektive për të bërë regjistrimin audio, nuk duhet të na pengojë, sa kohë interesi publik kërkon që ne të ecim me këto procedura. Kështu që unë jam dakord që të zhvillojmë në sallën që plotëson kushtet e sigurisë dhe të vijojmë me shqyrtimin e të gjitha projektvendimeve që kanë të bëjnë me çështje që lidhen edhe me informata të karakterit konfidencial apo sekret.

***Naureda Llagami***: Kemi ndonjë mendim apo diskutim?

E hedhim në votim që të biem dakord, nëse të gjithë jemi dakord, për këtë lloj formati?

***Alban Toro***: A mund të flasë?

***Naureda Llagami***: Po, Alban!

***Alban Toro***: Unë nuk shoh ndonjë ndryshim midis ambienteve që kemi patur atje, të paktën sallën plenare që kemi patur, me këtë këtu për nga madhësia.

***Naureda Llagami***: Në fakt Alban, ka një ndryshim shumë të madh. Por do e shohim bashkë. Ka një ndryshim sipërfaqeje, ka një ndryshim ventilimi, që nuk është njësoj si atje, ka dhe një ndryshim ajrimi sepse është sallë e cila ka dritare. Pra nuk bëhet fjalë për sallën e programuar për mbledhjet plenare, por bëhet fjalë për një ambient tjetër për të cilin kemi marrë masa për të zhvilluar këto mbledhje për të krijuar një distancë 2 m nga njëri-tjetri.

***Alban Toro***: Atëherë, këtë sallën nuk ma kanë bërë prezent stafi. Kam parë vetëm atë sallën plenare.

***Naureda Llagami***: Është një sallë edhe më e madhe, në fakt, pikërisht për të garantuar atë gjë që ne e kishim me merak që na pengoi deri tani.

***Alban Toro***: Vetëm nëse do të bëhet, mbani në konsideratë të fusni të parin kandidatin që e kemi mbajtur pezull nga data 12 shkurt, sepse unë ndryshe nuk relatoj asnjë kandidat tjetër pa hequr më parë këtë. Ndaç pranoni, ndaç refuzojeni, por vetëm jepini zgjidhje sepse nuk mbahet kaq gjatë. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Alban, unë kur e nisa fjalën time e nisa me kandidatin e katërt dhe thashë edhe të tjerët. Kështu që kuptohet gatishmëria nga ana ime është që të futen të gjithë relacionet që janë gati për këtë çështje. Do vendosim një ditë, do caktoj një ditë ku të futen të gjitha së bashku.

***Alban Toro***: Atëherë, stafi të na e bëjë prezent këtë dhe ta shikojmë dhe të konstatojmë ndryshimet me atë që kemi patur.

***Naureda Llagami***: Ajo që unë ngre sot për diskutim është nëse neve do pranojmë që të mbajmë pa audio procesverbalet.

***Alban Toro***: Për mua s'ka asnjë lloj problemi.

***Naureda Llagami***: Kjo është ajo që kërkoj.

***Alban Toro***: Absolutisht asnjë problem.

***Fatmira Luli***: Dakord jam edhe unë.

***Naureda Llagami***: E kalojmë në votim që ta kemi dhe ta shprehin të gjithë vullnetin?

***Erjon Muharremaj***: Më falni, mund të them diçka?

Mendoj që termi "votim" nuk shkon në kushtet që tashmë rendi i ditës është mbyllur për mbledhjen që kishim sot. Ndoshta një dakordësim që të vijojmë me proceset që i kemi në shqyrtim, do ishte më korrekt mendoj unë.

***Naureda Llagami***: Fatmira kishe gjë për të thënë?

***Fatmira Luli***: Unë isha dakord me propozimin që ju bëtë, për t'u futur në seancë plenare ashtu pa audio, me mbajtjen me procesverbal, meqenëse është çështje sensitive dhe është e rëndësishme për të gjithë ne që të shprehemi sa më shpejt. Rëndësi është që të biem dakord dhe i fusim në rend dite. Nuk ka rëndësi të votojmë tani. Biem parimisht dakord të gjithë.

***Naureda Llagami***: Këtë dua pra, dua dakordësinë tuaj për t'u futur dhe për ta mbajtur sepse ligji na detyron me audio dhe unë them – Jemi dakord të futemi dhe ta bëjmë me shkrim?

***Erjon Muharremaj***: Unë jam dakord.

***Dritan Hallunaj***: Mundem Kryetare?

***Naureda Llagami***: Po, Dritan!

***Dritan Hallunaj***: Edhe unë jam plotësisht dakord që të futemi në seancë plenare, qoftë edhe jo ambientet e parashikuara, dhe me shkrim, por thjesht duhet të kemi parasysh që do duhet të verifikojmë nëse është kushti që ka rënë që, përse nuk është zhvilluar në atë kohë dhe duhet të zhvillohet tani? Pra që do të thotë, që ato autoritete që na kanë penguar për të zhvilluar mbledhjen... se nuk është se ne e kemi lënë se kemi pas qejf ne apo e kemi penguar, ne na ka penguar  një akt, pra dikush që nuk ka lejuar që të zhvillohet ajo për arsye të pandemisë apo të ambienteve të vogla. Pasi të sigurohet ajo, plotësisht dakord - Se do kthehemi tek pjesa pse nuk e bëtë më shpejt këtë gjë. Kaq kisha. Të jemi të kujdesshëm. Por që jam dakord, jam plotësisht dakord. Që nesër po ashtu. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Atë që ju kam thënë edhe herën e fundit në fakt, ka qenë situata që ato autoritete në asnjë moment nuk na kthejnë edhe me të gjithë tentativat tona nuk na kanë kthyer përgjigje dhe kanë refuzuar të na bëjnë një protokoll të posaçëm për këtë situatë. Tani e gjithë dinamika është që me sallën që kishim nuk plotësonin edhe protokollet minimale që sot po përdoren nga të gjithë institucionet, qoftë edhe nga shkollat dhe nga kopshtet, qoftë edhe nga çdo lloj angazhimi publik që bëhet në këtë gjë në organizimet publike.

Me ardhjen këtu dhe me krijimin e këtyre sallave, pra është një sallë shumë e madhe, dhe me dezinfektimin, që quhet në gjuhën tjetër, pra me krijimin e një zone të sigurisë, kjo lloj salle, duke marrë parasysh protokollet që janë të vendosura sot në shkolla (që çojmë fëmijët tanë), kjo lloj salle, të paktën me distancat, na i krijon këtë gjë. Plus që ka edhe dy faktorë plus, e cila ka dritare, gjë që mos ta harrojmë që tek salla e mëparshme nuk kishim ajrim dhe e dyta, që është shumë e rëndësishme, nuk kemi kondicionim por kemi ventilim, gjë që edhe ky është një tjetër element mbrojtës. Tani, nëse unë do pres prapë, e di shumë mirë që nga këto institucione, nuk më ka ardhur dhe nuk krijojnë një protokoll të ri për këtë gjë. Nga kontaktet që unë kam pasur, nuk ma kanë krijuar, megjithatë unë prandaj e ngre këtë. Nga ana ime si Kryetare unë kam marrë masat për respektimin jo vetëm të mbrojtjes ndaj COVID por edhe të sigurisë së sallës që kërkon trajtimin e këtyre, kështu që e ngre për vlerësimin tuaj, si e gjykoni.

Nëse ju e gjykoni që unë duhet t'i çoj edhe një herë shkresë atyre për të ardhur dhe për të sjellë dhe për të detyruar të na bëjnë një protokoll, nga ana e stafit pa diskutim që kjo gjë bëhet brenda ditës së sotshme, nëse ju vlerësoni që duhet kjo gjë.

Kemi ndonjë sugjerim?

***Marçela Shehu***: Kryetare, ne sot kemi një dokument? Ju më duket e thatë, por më shumë për ta saktësuar, a kemi një akt nga një institucion shtetëror që të vërtetojë atë që tha Tani, salla jonë plenare, atje ku ishim, tek godina e vjetër, nuk na lejonte, sipas protokollit të caktuar, për të zhvilluar mbledhje, pra a kemi diçka të shkruar që të na e vërtetojë këtë?

***Naureda Llagami***: Marçela, në qoftë se ju kujtohet, jua kam përcjellë përgjigjen që sollën autoritetet, të cilët na thanë që ato nuk mund të japin, janë të ndaluara dhe ata nuk mund të japin, duhet një protokoll që bëhet nga një komitet. E kemi kërkuar edhe tek komiteti dhe komiteti nuk ka bërë një protokoll për në.

Atëherë, i gjithë diskutimi është që ato nuk na japin zgjidhje. Do vazhdojmë të qëndrojmë në këtë lloj situate, apo ne...

***Marçela Shehu***: Jo nuk është puna "na japin zgjidhje" sepse edhe ajo që thotë Tani qëndron. Tani, kjo salla e re, jemi ne ekspertët që e vendosim që kjo salla ka ventilim, ka hapësira, ka këtë e ka këtë. Pra duhet të jetë një autoritet që ta saktësojë ndryshimin nga a-ja tek b-ja.

***Naureda Llagami***: Atëherë, salla e re që është ofruar është një sallë e cila po të shkojmë edhe protokollet që kemi miratuar për veten tonë këtu, si për veten dhe për gjykatat, referuar edhe protokolleve që kanë nxjerrë Ministria e Shëndetësisë, i plotëson kriteret që kanë të bëjnë me distancimin 2 m, me ajrosjen sepse ka dritare dhe me ventilimin. Këto janë 3 elementet kryesorë që diskutohet në këto lloj protokollesh.

Tani nëse ne duam që ata të na krijojnë një protokoll të posaçëm, me sa duket nuk na krijojnë një protokoll, pas të gjithë kontakteve që kam krijuar, nuk na e japin atë protokoll të posaçëm. Pra kanë krijuar një protokoll të posaçëm vetëm për Kuvendin e Shqipërisë, për asnjë organ tjetër kolegjial nuk kanë krijuar protokoll të posaçëm. I gjithë diskutimi është nëse ne duam të zhbllokojmë situatën apo nuk duam të zhbllokojmë situatën. Nëse ju vlerësoni që jo, duhet të presim ta krijojnë ata për ne protokollin e posaçëm, atëherë le të presim, le t'i ngacmojmë prapë, le t'i themi prapë dhe le të presim derisa të na vijë një përgjigje prej tyre për

protokollin, sepse ne ia kemi çuar shkresën dhe i kemi thënë që ju lutem na e bëni protokollin dhe nuk na kanë kthyer. Atëherë, kjo është pjesë, nga ana tjetër, duke marrë parasysh edhe rëndësinë dhe gjithashtu duke marrë parasysh edhe nga ju vet më është adresuar kjo çështje, jam munduar që në zbatim të udhëzimit orientues që kemi miratuar vet ne si për stafin tonë edhe për gjykatat, të marrë masat që në godinën e re të kemi një ambient të tillë.

***Marçela Shehu***: Atëherë, Kryetare, besoj ne të gjithë kemi dëshirën e madhe që situata jo vetëm të zhbllokohet por ne të ecim me ritme sa më të shpejta. Problemi është që ju personalisht e merrni përsipër të përcaktoni që godina e vjetër nuk i përmbushte kushtet e protokollit dhe kjo i përmbush kushtet e protokollit sepse lind ajo pyetja që tha edhe Tani, që ku shkon kjo përgjegjësia, pse nuk u zhvillua mbledhja deri tani? Nëse e merrni ju përsipër në përgjegjësinë tuaj personale, që ju e vlerësoni që tani kjo sallë është me kushte të larta sigurie, etj., etj., ne ecim. Por besoj edhe ajo që tha Tani edhe kjo që po them unë, besoj edhe të tjerët sepse asnjeri nuk do që të pengohet, të gjithë duam që mbledhjet të zhvillohen, madje sa më shpejt. Është vetëm ajo çështja që do diskutohet dhe madje besoj që po diskutohet që, -pse kjo mbledhje nuk u zhvillua deri tani, por po zhvillohet sot.

***Naureda Llagami***: Ky ishte një propozim i imi, duke marrë parasysh infrastrukturën e re që ne kemi. Nëse nga ana juaj vlerësohet që jo, duhet të presim të krijohet që ta kemi të sigurt të kemi një protokoll të posaçëm për KLGJ-në, unë jam shumë e hapur që të vijojmë komunikimin shkresor nga autoritetet përkatëse. Thjesht unë duke parë natyrën e punës, duke parë dinamikën që ne kemi, distancat që mbajmë nga njëri-tjetri dhe duke kuptuar rëndësinë që keni, kam krijuar këtë mundësi, duke marrë parasysh të gjithë detyrimet që na thonë protokollet. Nëse neve nuk na mbushet mendja dhe prandaj e shtrova për diskutim, nëse ne e konsiderojmë këtë gjë si të pamundur, atëherë okej, vazhdojmë diskutimin derisa komiteti të hartojë një listë, një protokoll të posaçëm për në.

***Brunilda Kadi***: Mundet Kryetare, në qoftë se mbaroi Marçela.

***Naureda Llagami***: Po, Bruna!

***Brunilda Kadi***: Atëherë, unë personalisht jam shprehur shumë herët në lidhje me këtë situatë dhe kam pasur mendimin tim që ne nuk kemi pasur asnjë pengesë për të zhvilluar mbledhjen, nisur edhe nga praktika e shumë institucioneve të tjera siç është Këshilli i Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë, Gjykata e Lartë e me radhë që kanë zhvilluar dhe nuk i kanë penguar as

pandemia, as mungesa e dritareve, as e ventilimit, as e kondicionimit dhe mendoj që është përgjegjësi e atij që drejton mbledhjen, që nuk u bë mbledhja por do bëhet mbledhja sepse nuk ka nevojë të citoj ligjin, kështu që unë jam dakord, që atëherë kam qenë dakord që të bëheshe mbledhja edhe për këtë formën, për mungesën e regjistrimit audio, siç kemi bërë edhe herë të tjera mbledhje që i mbajmë procesverbalin me shkrim dore për arsye të tjera, pra nuk na kishte penguar asnjë gjë që ta kishim bërë më përpara dhe unë uroj zonja Kryetare që të njëjtin kujdes të keni pasur edhe kur keni sistemuar nëpër zyra, për shembull le të marrë rastin e Këshilltarëve Ligjorë që janë 6 persona në një ambient shumë herë më të vogël sesa ambientet e tjera. Janë 6 persona në një sipërfaqe shumë herë më të vogël sesa ambientet e zyrave tona personale. Unë uroj shumë që ju të keni pasur po të njëjtin kujdes dhe të keni zbatuar po të njëjtin protokoll kur keni vendosur që i keni futur në ato lloj ambientesh, gjithmonë flas për sigurinë në lidhje me virusin. Kështu që për mua, i gjithë ky diskutimi s'ka asnjë lloj lidhjeje. Unë jam shprehur para shumë muajsh që ne duhet ta bëjmë shumë shpejt atë mbledhje, kudo qoftë. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Atëherë, Bruna, në thelb je dakord që ta zhvillojmë mbledhjen edhe pa audio?

***Brunilda Kadi***: Po, patjetër, se e kemi zhvilluar edhe pa audio në raste të tjera. Jam shumë dakord.

***Naureda Llagami***: Është ndonjë kundër faktit që ta zhvillojmë mbledhjen pa audio në ambientin që kemi?

Nëse nuk jemi kundër, e lexoj këtë heshtjen tuaj, që biem dakord të gjithë bashkë që mund ta bëjmë mbledhjen në një nga ambientet që unë kam bërë gati dhe që është cilësuar edhe si ambient i sigurisë pa audio, duke mbajtur procesverbalin. Ndërkohë jeni të ftuar të gjithë prej jush që të shkojmë dhe t'i hidhni një sy ambientit që keni në katin e dytë, lidhur me zhvillimin e mbledhjeve tona për këto lloj rastesh.

Kemi ndonjë gjë tjetër përpara se ta mbyllim?

Atëherë, meqë s'keni kundërshtime u dakordësuam.

Punë të mbarë!

Gjithë të mirat!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**